



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1172

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AK INVEST DOOEL Tetovo., ankesës se OE **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, ankesës se OE Raf II Sh.P.K., si dhe ankesës se OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Ministria e Shëndetësisë., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj” me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, me 02.03.2026, mori:

Vendim

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat e OE INVEST DOOEL Tetovo., me nr. 2025/1172, e datës 01.12.2025, ankesa e OE **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, me nr. 2025/1173, e datës 01.12.2025, ankesa e OE Raf II Sh.P.K., me nr. 2025/1175, e datës 01.12.2025 si dhe ankesa e OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K., me nr. 2025/1182 e datës 01.12.2025 lidhur me aktivitetin e Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj” me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, inicuar nga AK - Ministria e Shëndetësisë.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë., për aktivitetin e prokurimit Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj” me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesit kanë të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Shëndetësisë., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.04.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj” me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1.

Me datën 12.11.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës **GOE ADA Consulting Group SHPK & SHM Architecture SHPK & Termo Consing SHPK.**

Me datën 17.11.2025, (OE) INVEST DOOEL Tetovo., OE **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, OE Raf II Sh.P.K., OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K., kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK kundër vendimit për dhënie të kontratës. Me datën 20.11.2025 dhe 21.11.2025 AK ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të OE-ve të lart cituara.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me dt. 01.12.2025 operatori ekonomik INVEST DOOEL Tetovo., ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1172 (Nr. protokolli).

Kundër vendimit të cituar si më sipër me dt. 01.12.2025 operatori ekonomik **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1173 (Nr. protokolli).

Kundër vendimit të cituar si më sipër me dt. 01.12.2025 operatori ekonomik Raf II Sh.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1175 (Nr. protokolli).

Kundër vendimit të cituar si më sipër me dt. 01.12.2025 operatori ekonomik NIKA PrO – Ing Sh.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1182 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Duke ju referuar ankesave si më sipër, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim neni 16 (Rastet e unifikuara) i Rregullores së cituar, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë që ti bashkoj Lëndët/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar.

Lidhur me ankesën INVEST DOOEL Tetovo., ankesën e OE **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, ankesën e OE Raf II Sh.P.K., si dhe ankesën e OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K., eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues arpyohet pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE INVEST DOOEL Tetovo.,

Pretendimi ankimor te OE AK INVEST DOOEL Tetovo

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues e konteston Marrëveshjen e konsorciumit, sipas tyre Marrëveshja e operatorit fitues ka ndërhyrje në marrëveshjen e konsorciumit, përkatësisht në Aneksin 6 të dosjes së tenderit, ku janë fshirë:

Numri i prokurimit: 206-25-80-5-1-1 dhe titulli i kontratës: “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj – vazhdim projekti”, në mënyrë të paautorizuar, me çka ka bërë shkelje të dispozitave përkatëse ligjore, përkatësisht nenin 44, paragrafin 44.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, citoj: neni 44 paragrafi 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde ishte që të ndihmohen operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.

Ky pretendim nuk qëndron, megjithëse Marrëveshja e konsorciumit e operatorit të rekomanduar i posedon të dhënat e aktivitetit, titullin dhe nr. e prokurimit, ndërsa mungesa e header/footer nuk është fare relevante.

Gjithashtu OE kanë dhënë edhe deklaratat të përbashkëta dhe veç e veç për pjesëmarrje në këtë konsorcium, me titull dhe nr. të prokurimit. – Shih për dëshmi marrëveshjen dhe deklaratat.

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2

OE ankues e konteston sqarimin vetëm të njëjës bankë për deklaratat e ofruara nga OE i rekomanduar për mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti.

Ky pretendim është i pabazuar. Ju rikujtojmë se bazuar në nenin 59 të LPP-së, vlerësimi i tenderit është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast MSh.

Dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar e tejkalojnë kërkesën e tenderit, megjithëse ne kemi kërkuar vetëm vërtetim bankar (shënim premtues), ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar Letër Konfirmimi me limit të aprovuar nga dy bankat (Pro Credit Bank dhe NLB) me nga 4 milion euro secila, në total 8 milion, sipas kërkesës më poshtë të NJK dhe DT:

Dëshmia 2. Letër konfirmimi (deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej tetë (8) milion

EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Gjatë vlerësimit është vërtetuar vetëm te Pro Credit Bank, meqenëse për NLB sipas përshkrimit në Letër Konfirmim nuk është parë e nevojshme.

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 3

Sa i përket vërtetimit tatimor nga ATK për anëtarin e grupit Termo Consing SH.P.K, që është në marrëveshje me ATK-në për shlyerje të borxheve, është e lejuar që kjo kërkesë e përshtatshmërisë të dëshmohet me marrëveshje me ATK-në.

Ky pretendim është i pabazuar. Si duket nuk e keni lexuar mirë dëshminë të kërkesa e përshtatshmërisë, ku ne e kemi specifikuar para dorëzimit të tenderit e jo para NJK-së:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga operatori ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Të njëjtën e keni dëshmuar edhe ju në ofertën tuaj, shih vërtetimin tatimor për HIDRO PROJECT.

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 4

OE ankues konteston dëshmitë e ofruara (kontrata e punës) nga OE i rekomanduar për stafin profesional: për Arkitektin z. Krenar Veseli, Inxhinieren e Ndërtimtarisë znj. Njomza Hoti, Inxhinierin e Hidros z. Premton Thaqi, Inxhinierin e Elektros z. Agim Kastrati, Inxhinierin e Makinerisë z. Blerim Koci.

Këto pretendime janë të pabazuara, megjithëse dëshmitë e kërkuara në NJK dhe DT për stafin e rregullt është kërkuar të dëshmohet me listë të ATK-së, shih kriterin:

Për inxhinierët e rregullt kërkohet lista e ATK-së me kontributet e realizuara së paku për tre muaj gjatë 12-mujorit të fundit nga Njoftimi për kontratë. Sa i përket Inxhinierit të Makinerisë z. Blerim Koci dhe Inxhinierit të Hidros z. Premton Thaqi, për të cilët është dëshmuar parakontrata, në të cekën të dhënat e projektit, orari i punës 8:00–16:00, paga bruto 1000 euro, ndërsa ne nuk kemi kërkuar në kriter që orari të jetë i plotë për çdo inxhinier, meqenëse përveç menaxherit të projektit angazhimi i inxhinierëve bëhet sipas fazave të kryerjes së punëve.

Inxhinierët tjerë: Krenar Veseli, Njomza Hoti, Agim Kastrati, janë staf i rregullt me kontribute në ATK, shih për dëshmi listën e kontributeve në ATK.

Sqarim shtesë:

Duke marrë parasysh se ju keni bërë pretendime të pabazuara, me qëllim të gjetjes së defekteve të vogla në ofertën e OE të rekomanduar, ju sqarojmë se defektet e vogla i lejon neni 59.4 i LPP-së:

(i) përmban vetëm devijime të vogla nga karakteristikat që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që çdo devijim i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Njëkohësisht ju sqarojmë se oferta juaj është cilësuar si e pasuksesshme duke marrë parasysh se nuk keni qenë pretendent për kontratë – keni qenë e parafundit për nga çmimi i ofruar, ose rreth 3 milion më e shtrenjtë se sa oferta e rekomanduar.

Oferta juaj – 26,869,642.04 €

Oferta e rekomanduar – 23,992,180.83 €

Përndryshe oferta juaj nuk është pa defekte, përkundrazi defektet në ofertën tuaj janë shumëfish më të mëdha se sa pretendimet tuaja për ofertën e rekomanduar.

Disa nga defektet e vërejtura:

Sigurimi i ofertës është bërë vetëm për anëtarin e konsorciumit Hidroprojekt, ndërsa në bazë të marrëveshjes së konsorciumit lider me të gjitha kompetencat dhe autorizimet është AK Invest. Kjo formë e sigurimit të tenderit e bën ofertën tuaj potencialisht të papërgjegjshme administrativisht.

Defekte të punëtorët teknik: për disa nga punëtorët teknik certifikatat e kualifikimeve profesionale për siguri dhe shëndet në punë janë në emër të kompanisë “Meja Construction Sh.p.k.”, e cila kompani nuk është pjesë e kësaj oferte. Gjithashtu edhe të stafi profesional, disa prej inxhinierëve që i keni ofruar janë pronarë të kompanive tjera.

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, mund të konkludojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara dhe ne si AK kemi vepruar drejtë duke e shpërblyer me kontratë ofertën e përgjegjshme, njëkohësisht duke e ruajtur buxhetin e shtetit, meqenëse e kemi shpërblyer me kontratë ofertën për 3 milion euro më të lirë se sa oferta juaj.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi

Përgjigja e AK në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues

Përgjigja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1

Sa i përket pretendimit ku ju si OE ankues i keni kontestuar arsyen e eliminimit tuaj për shkak të mosplotësimit të vlerës së kërkuar 35 milion euro projekte në tre vitet e fundit, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh kriterin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1. Një listë e projekteve të realizuara – origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna:

Titullin e kontratës,

Investitorin,

Të dhënat e personit kontaktues,

Datën e përfundimit të projektit,

Vlerën e projektit.

Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale).

Për OE pretendues për kontratë, AK do t'i verifikojë transaksionet bankare të projekteve private.

Projekti i liderit të grupit YBT INSAAT VE TICARET LIMITED SIRKETI me titull "Medicine Hospital Construction Work & Contractor", në shumën 282,750,250.00 TRL, i takon sektorit privat me MEDICINE TEKNOLOJI VE SAGLIK YATIRIM A.S., andaj sipas kriterit të tenderit nuk e keni ofruar paramasën e punëve të kryera, siç është kërkuar në NJK dhe DT.

Kursit të këmbimit ne si AK i kemi referuar datës së referencës 01.09.2024, meqenëse në ofertën tuaj si dëshmi ju keni ofruar vetëm referencën, ndërsa nuk keni ofruar ndonjë dëshmi tjetër, as kontratë e as paramasë, siç është kërkuar.

Meqenëse ju pretendoni se ky projekt në kohën e kontraktimit ka qenë në vlerën 45,674,865 euro, si mund të jetë bindëse për AK dëshmia për një projekt kaq të madh vetëm me një dokument reference nga privati, e ofruar në gjuhën turke, ndërsa përkthimi i të cilës nuk është bërë nga ndonjë përkthyes i licencuar, por është vetëm përshkrim narrativ pa autorësi të përkthyesit.

Si AK kemi të drejtë që komplet këtë referencë të mos e pranojmë për shkak se është dokument në gjuhën turke, e cila nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe nuk ka përkthim adekuat.

Përgjigja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2

Sa i përket pretendimit ku ju si OE ankues e keni kontestuar Marrëveshjen e konsorciumit të operatorit të rekomanduar, ky pretendim nuk qëndron, meqenëse Marrëveshja e konsorciumit e operatorit të rekomanduar i posedon të dhënat e aktivitetit, titullin dhe numrin e prokurimit, ndërsa mungesa e Header/Footer Tools nuk është fare relevante.

Nuk qëndron pretendimi se mungon data e autorizimit në marrëveshje. Shih më poshtë marrëveshjen e operatorit të rekomanduar: është e plotësuar dhe është e specifikuar data 22.07.2025.

Përgjigje për pikën 2

Sa i përket Vërtetimit Tatimor nga ATK për anëtarin e grupit Termo Consing SH.P.K., i cili është në marrëveshje me ATK-në për shlyerje të borgjeve, është e lejuar që kjo kërkesë e përshtatshmërisë të dëshmohet me marrëveshje me ATK-në.

Ky pretendim është i pabazuar.

Si duket nuk e keni lexuar mirë dëshminë të Kërkesat e përshtatshmërisë, ku ne e kemi specifikuar para dorëzimit të tenderit e jo para NUK:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit aktual. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Përgjigje për pikën 3

Sa i përket pretendimit ku e keni kontestuar një referencë të ofertës së rekomanduar, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh se edhe pa këtë projekt OE i rekomanduar e ka tejkalluar kriterin e tenderit.

OE i rekomanduar ka ofertuar me listën e projekteve në vlerë të përgjithshme prej 48,549,858.97 €, ndërsa bazuar në vlerësimin e komisionit vlerësues në përbërje prej dy inxhinierëve dhe një juristi me kualifikim të lartë (me gradën e jurisprudencës), vlera e projekteve të realizuara dhe të kompletuara me dokumentacion përkatës sipas kërkesës arrin vlerën 39,880,160.31 €, që e tejkallon kërkesën e tenderit prej 35 milion euro.

Përgjigje për pikën 4

Sa i përket pretendimit ku e keni kontestuar stafin e inxhinierëve të ofertës së rekomanduar që sipas jush nuk figurojnë në listat e ATK-së, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh se sipas dëshmive të kërkuara në NUK dhe DT vetëm për stafin e rregullt është kërkuar të dëshmohet me listë të ATK-së, ndërsa për stafin jo të rregullt janë kërkuar parakontratat, të cilat i ka ofruar OE i rekomanduar.

Shih dëshmitë për këtë pretendim:

Për inxhinierët e rregullt kërkohet lista e ATK-së me kontributet e realizuara së paku për tre muaj gjatë 12-mujorit të fundit nga Njoftimi për kontratë;

Për inxhinierët jo të rregullt kërkohet marrëveshja e punës për këtë projekt konform Ligjit të Punës, të nënshkruara nga të dyja palët.

Si përfundim, ju keni bërë pretendime me qëllim të gjetjes së defekteve të vogla në ofertën e OE të rekomanduar, ndërsa siç e dini defektet e vogla i lejon neni 59.4 i LPP-së:

(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, mund të konkludojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara dhe ne si AK kemi vepruar drejt duke e shpërblyer me kontratë ofertën e përgjegjshme, njëkohësisht duke e ruajtur buxhetin e shtetit, meqenëse e kemi shpërblyer me kontratë ofertën për rreth 660,000 euro më të lirë sesa oferta juaj.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE Raf II Sh.P.K.,

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor të OE RAF II SH.P.K.

Sa i përket pretendimit ku ju si OE ankues i keni kontestuar arsyet e eliminimit tuaj për shkak të mosplotësimit të vlerës së kërkuar 35 milion euro projekte në tre vitet e fundit, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh kërkesën e tenderit, sipas së cilës për çdo projekt të realizuar kërkohej referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale).

Në momentin që ju në ofertën tuaj i keni ofruar pranimet teknike me data jashtë tri viteve të fundit, siç është kërkuar, komisioni vlerësues nuk e ka parë të arsyeshme të kërkojë dokument shtesë. Ndërsa, sikur të ishte kriteri pranimet teknike finale, atëherë ne nuk do ta merrnim për bazë pranimin e përkohshëm, por do t'ua kërkonim pranimin final.

Sa i përket pretendimit ku ju si OE ankues e keni kontestuar vlerën e referencave të ofertës së rekomanduar, sipas jush nuk arrihet vlera e kërkuar 35 milion euro projekte në tre vitet e fundit, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh se OE i rekomanduar ka ofertuar me listën e projekteve në vlerë të përgjithshme prej 48,549,858.97 €, ndërsa bazuar në vlerësimin e komisionit vlerësues në përbërje prej dy inxhinierëve dhe një juristi me kualifikim të lartë (me gradën e jurisprudencës), vlera e projekteve të realizuara dhe të kompletuara me dokumentacion përkatës sipas kërkesës arrin vlerën 39,880,160.31 €, që e tejkalon kërkesën e tenderit prej 35 milion euro.

Sa i përket pretendimit për deklaratat bankare të ofruara nga OE i rekomanduar për mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar e tejkalojnë kërkesën e tenderit.

Ne kemi kërkuar vetëm vërtetim bankar (shënim premtues), ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar Letër Konfirmimi me limit të aprovuar nga dy banka (ProCredit Bank dhe NLB), me nga 4 milion euro secila, në total 8 milion euro, sipas kërkesës së përcaktuar në NJK dhe DT, si më poshtë:

Dëshmia 2. Letër konfirmimi (deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion euro në llogarinë bankare të kompanisë. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Gjatë vlerësimit të ofertave është verifikuar vërtetimi i ProCredit Bank, ndërsa për NLB, sipas përshkrimit në Letrën e Konfirmimit, nuk është parë e nevojshme.

Ndërsa sa i përket konstatimit tuaj se ofertat tjera më të lira se oferta juaj me të drejtë janë eliminuar nga AK, me këtë edhe ne pajtohemi dhe qëndrojmë pas njoftimeve – Letrave standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 12.11.2025.

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, mund të konkludojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara dhe ne si AK kemi vepruar drejt duke e shpërblyer me kontratë ofertën e përgjegjshme, njëkohësisht duke e ruajtur buxhetin e shtetit, meqenëse e kemi shpërblyer me kontratë ofertën për rreth 2.5 milion euro më të lirë sesa oferta juaj.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE Nika Pro - Ing Sh.P.K.,

Përgjigjet e AK në lidhje me pretendimin ankimor të OE NIKA PRO-ING

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1

Sa i përket pretendimit për Vërtetimin Tatimor nga ATK për anëtarin e grupit Termo Consing SH.P.K., që është në marrëveshje me ATK-në për shlyerje të borgjeve, është e lejuar që kjo kërkesë e përshtatshmërisë të dëshmohet me marrëveshje me ATK-në.

Ky pretendim është i pabazuar dhe, si duket, nuk e keni lexuar mirë Dëshminë të Kërkesat e Përshtatshmërisë, ku ne e kemi specifikuar para dorëzimit të tenderit e jo para NJK-së:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit aktual. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Bazuar në nenin 59 të LPP-së, vlerësimi i tenderit është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast MSh-së.

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2

Sa i përket pretendimit për garancionin sipas Aneksit 1, ky pretendim është i pabazuar, meqenëse kërkesat e Aneksit 1 janë kushte të kontratës e jo kërkesa për ofertim.

Sidoqoftë, OE i rekomanduar këtë e ka plotësuar me rastin e plotësimit të Formularit të Tenderit, si në vijim:

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I – Formulari i Tenderit

2/4

Numër i Prokurimit: 206-25-80-5-1-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi i Objektivit të Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj – vazhdim projekti

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 3

Sa i përket pretendimit për arsyen e eliminimit tuaj për Letër mbështetjeje nga banka, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh vlerësimin e bërë nga komisioni vlerësues në përbërje prej dy inxhinierëve dhe një juristi me kualifikim të lartë (me gradën e jurisprudencës), të cilët kanë konstatuar se ju keni ofertuar një letër mbështetjeje të lëshuar nga Raiffeisen Bank, me datë 25 korrik 2025, në emër të OE AKTIV SH.P.K.

Në këtë shkresë banka shpreh gatishmërinë për të mbështetur OE-në me një kredi në vlerë prej 8,000,000.00 € për implementimin e projektit/tenderit “Ndërtimi i objektivit të Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj – vazhdim projekti”, me Nr. të prokurimit 206-25-80-5-1-1, por me kusht që klienti të plotësojë kriteret dhe kushtet e brendshme të bankës për një kredi të tillë.

Duke u bazuar në kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit, ku është specifikuar qartë se OE/GOE duhet të ketë asete likuide në llogari ose qasje për kredi në dispozicion, letra e paraqitur nga banka nuk përmbush kriterin e kërkuar. Arsyeja është se dokumenti i ofruar është i kushtëzuar dhe nuk garanton disponueshmërinë e shumës, por vetëm mundësinë për të marrë kredi nëse plotësohen kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. Si e tillë, kjo letër nuk e plotëson kriterin e lartcekur.

Përgjigjja e AK në lidhje me pretendimin ankimor nr. 4

Sa i përket pretendimit ku ju si OE ankues i keni kontestuar arsyet e eliminimit tuaj për shkak të mosplotësimit të vlerës së kërkuar 35 milion euro projekte në tre vitet e fundit, konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar duke marrë parasysh kërkesën e tenderit, sipas së cilës për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale).

Ju, si Grup i Operatorëve Ekonomikë, keni dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragon prej 35 milion euro.

Lideri i grupit, OE Anion Mep Contracting, ka ofruar një listë për punët e realizuara, së bashku me kontratat dhe referencat; sipas listës së dorëzuar, projektet me numër rendor 5 dhe 6 nuk janë të pranueshme, pasi që nuk janë të përfunduara – janë në realizim.

Ndërsa projektet në listë me numër rendor 1, 2, 3 dhe 4 janë projekte ku OE Anion Mep Contracting ka qenë i angazhuar si nënkontraktor, ku ka ofruar kontratat e lidhura me OE Generic Engineering Technologies & Contracting W.L.L dhe Sigma Contracting & Trading W.L.L, si dhe referencat e lëshuara nga këta dy operatorë ekonomikë.

Bazuar në kriterin e tenderit, për projektet e realizuara për investitorë privatë është e domosdoshme paraqitja e certifikatës së pranimi nga komuna ose certifikatave të pranimi të lëshuara nga kompani të licencuara dhe të autorizuar në vendin ku është kryer ndërtimi. Këto dokumente nuk janë ofruar nga lideri i GOE-së dhe, duke marrë parasysh se është i papërgjegjshëm edhe për çështjen e përkrahjes nga banka, nuk kemi kërkuar sqarime shtesë në këtë pikë.

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, mund të konkludojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara dhe ne si AK kemi vepruar drejt duke e shpërblyer me kontratë ofertën e përgjegjshme, njëkohësisht duke e ruajtur buxhetin e shtetit, meqenëse e kemi shpërblyer me kontratë ofertën për rreth 1.8 milion euro më të lirë sesa oferta juaj.

Ju keni bërë pretendime me qëllim të gjetjes së defekteve të vogla në ofertën e OE-së së rekomanduar, ndërsa siç e dini defektet e vogla i lejon neni 59.4 i LPP-së:

(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "INVEST DOOEL Tetovo," ne ankesën Nr. 1172/2025 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1

Pas kërkesës për çasjen në dokumentet e ofertës së grupit të operatorve ekonomik të rekomanduar për kontratë më datën 14.11.2025 na është mundësuar qasja gjatë shiqimit një nga një të dokumenteve në ofertën e rekomanduar për kontratë kemi hasur në shumë parregullësi dhe mangësi të dokumenteve nga të cilat oferta e rekomanduar ishte ofertë e pa përgjegjeshme sepse: Grupi Operatorve Ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë ndërhyrë në formatin zyrtarë të marrëveshjes për krijimin e grupit e cila është fiksuar në dosje tenderit, përkatesisht tek pjesa e titullit të projektit të marrëveshjet për krijimin e grupit të operatorve.

Forma standarte e marrëveshjes në formën standarde ishte e fiksuar në dosjen e tenderit përkatesisht në aneksin 6 ku janë fshirë “Numri i prokurimit: 206-25-80-5-1-1 dhe titulli kontrates: Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”, në mënyrë të pa autorizuar me çka ka bërë shkelje të dispozitivave përkatese ligjore përkatesisht nën 44, paragrafin 44.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik citoj: nën 44, paragrafi 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.

Deklaratat për krijimin e grupit duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde.

Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde. Me këtë dyshojm se G-OE i rekomanduar për kontratë i ka bashkëngjitur aneksi 6 i cili nuk ka të bëjë me tenderin në fjalë por është aneksi 6 i ndonjë tenderi tjetër për arsye se nuk ka numër të prokurimit dhe titull të kontratës (ku siç dihet se numëri i prokurimit dhe titulli i kontratës vendoset nga AK-ja me qëllim që të mos ketë keqperdorime të tilla).

Mungesa e numërit të prokurimit dhe titullit të projektit e cila nuk është sipas kërkesës zyrtare të marrëveshjes për krijimin e grupit të operatorve ekonomik e bënë që oferta e rekomanduar është ofertë e pa përgjegjeshme në aspektin administrativ sepse çështja e marrëveshjes është akti kryesor i cili mundëson krijimin e grupit të operatorëve. Si dhe çështja e tillë është e rregulluar në Rregullorën nr. 001/2022 për Prokurim Publik përkatesisht nënparagrafi 26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhe t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.

Dëshmi se si është prezantuar marrëveshja për krijimin e G-OE-ve, ofertat e rekomanduar për kontratë:

Ne kemi kërkuar nga Komisioni Rregullativ Për Prokurim Publik, interpretim ligjorë lidhur me pretendimin tonë ankimor duke kërkuar parashtruar pytyjën: Kemi pranur përgjigjën zyrtare ku është thënë se:

Në pjesën e interpretimit ligjore të dispozitave të Rregullorës për Prokurim Publikë Nr.001/2022, ndër të tjera është thënë se: Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Nga ky parim ligjorë i nenit 44 Formularët Standard paragrafet

44.1 AK do të përgatisë dokumentet e tyre të prokurimit duke përdorur formularët përkatës standard qëdo të gjenden në faqen e internetit të KRPP-së.

44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët Ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. O 44.3 Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde.

Një fakt më rendësi në marrëveshjen për krijimin e G-OE-ve është caktuar lidëri i grupit ndërsa përsone i autorizuar sipas nënshkrimit dhe të dhënava është një antar tjerër i kësaj marrëveshje. Fakti tjetër që vë në dyshim edhe legjitimitetin e nënshkrimit është krahasueshmëria e tyre siç mund të shihni në foto si pjes e shkëputur nga dokumentet e ofertës së rekomanduar, përkatësisht marrëveshja për krijimin e grupit të operatorve ekonomik:

Nga kjo pamje vërehet kuart se janë dy nënshkrimet si i till vë në dyshim legjitimitetin e nënshkrimit. Në të gjitha dokumentet e në veqanti në dokumentet të cilat përmbajn nënshkrime vërehet se nënshkrimet nuk janë origjinale dhe duke pasur parasysh se ne kemi përvoj në shum aktivitete nga të cilat janë trajtuar çështjen e nënshkrimit dhe oferta jonë është eliminuar duke pretenduar se nënshkrimet në disa dokumente nuk janë origjinale Saktësisht në një procedurë në atautoritetin e njëjt Ministria e Shëndëtësis në procedurën me të dhënat e aktivitetit:

Ne, jemi eliminuar pikërisht për shkak të nënshkrimeve të cilat nuk kanë qenë origjinale. Andaj, të gjitha nënshkrimet në dokument si: Marrëveshja për krijimn e grupit të operatorve, Deklaratat nën Detim dhe aktet të tjera përmbajn nënshkrime kopje. E me të fuqishëm e bënë pretendimet tona vlerësimi dyfisht për operatorët pjesëmarrës në këtë aktivitet për faktin se AK ka eliminuar nga gara: Dëshmi numër 1 vendimi AK- lidhur me trajtimin e rasteve për marrëveshjet për krijimin e grupi të Operatorve Ekonomik:

Dëshmi numër 1 vendimi AK- lidhur me trajtimin e rasteve për marrëveshjet për krijimin e grupi të Operatorve Ekonomik

Andaj, bazuar në të thënat dhe argumentet në prendimin 1, kërkojm nga stafi profesional dhe Paneli Shqyrtues që lëndën ta kthej në ri-vendosje duke anuluar vendimin për dhënjë kontratë dhe ofertën e rekomanduar ta shpallni të pa përgjegjëshme nga aspekti administrativ.

Pretendimi ankimor 2

Kërkesa në dosjen e tenderit përkatësishtë në FDT: Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare:

Kushti në dosje të tenderit:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë që mund ti përdori për këtë projekt ose mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti-limit financiar të aprovuar në emër të projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro – G-OE kanë dorezuar me ofertë dy leter perakrahe në emër të Ada Consulting Group sh.p.k të leshuara nga bankat: NLB Banka dhe Pro Credit Bank. Për këto dy letërperakrahe komisioni ka kërkuar sqarim vetëm të njerën nga bankat përkatesisht në Pro Credit bank, e cila e ka konfirmuar që klienti i saj ka të aprovuar limit kredin në vlerë prej 4,000, 000.00 euro.

Ndërsa AK-ja ka bërë shkelje për faktin se fare nuk ka kërkuar sqarim zyrtarisht në Bankën NLB Bankë për operatorin ekonomik në fjalë që do të vërtetonte dhe do të konfirmonte që klienti i saj ka të aprovuar limitin kreditor në vlerë prej 4,000,000.00 euro edhe se të njëjtën vlerë e ka a po nuk e ka të shfytëzueshme.

Ky pretendim nuk është shqyrtuar nga AK në kërkesën për riqyrtim Sipas analizës sonë në dokumentet e Ada Consulting Group, OE Ada ka bërë edhe garancionin e ofertës në NLB Bankë në vlerë prej 300,000.00 Euro, ky sigurim vlen deri me datën 22.12.2025 në ora 16:00. Përderisa banka NLB ka bërë edhe garancionin e ofertës atëherë do të thot se: Ada Consulting Group tani më për këtë projekt ka të aprovuar 3,700,000.00 euro ($4,000,000.00 - 300,000.00 = 3,700,000.00$ limiti kreditor - garancioni i ofertës = mbetja e limitit kreditor Pro Credit bank 4,000, 000.00 NLB 3,700,000.00 = 7,700,000.00.

Prandaj, pretendimi jonë ankimore lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit për letër grancionin bankarë është nën shumën e kërkuar nga autoriteti kontraktues. Sepse AK-ja nuk ka kërkuar sqarim plotësisht edhe nga NLB Bank, dhe me këto fakte OE Ada Consulting Group nuk e plotëson kushtin : që do të vërtetonte dhe do të konfirmonte që klienti i saj ka të aprovuar limitin kreditor në vlerë prej 4,000,000.00 euro edhe se të njëjtën vlerë e ka a po nuk e ka të shfytëzueshme Autoriteti Kontraktues duke cenuar rënd aktet ligjore të LPP-së, Saktësisht Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafet O 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. O Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Andaj, bazuar në të thënat dhe argumentet në pretendimin 2, kërkojm nga stafi profesional dhe Paneli Shqyrtues që lëndën ta kthej në ri-vendosje duke anuluar vendimin për dhënjë kontratë dhe ofertën e rekomanduar ta shpallni të pa përgjegjëshme.

Pretendimi numër 3

Në dosjen e tenderit tek pjesa, Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik

Pas, qasjes në dokumentet e pershtatshmëris së operatorve ekonomik të rekomanduar për kontratë më saktësisht “Vërtetimet Tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës”, njëri nga operatorët ekonomik (Termo Consing SH.P.K) ka dorzuar vërtetimin tatimore në kundërshtim me parimet ligjore të prokurimit publikë B05 Njoftim per Kontrat është me datë 02.04.2025

Vërtetimi tatimor është me datë 07.11.2025 dhe i njëjti është në marrëveshje për shlyerjen e borgjeve në ATK që nga data 11.06.2025, si dhe në faktë që i bie së është në kundërshtim me kërkesat ligjore të AK të kërkuara në dosjen e tenderit ku është thënë se: Provë: Vërtetimi i Kontestushëm në prendimin ankimor “

c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Ky pretendim argumentohet edhe më fuqishëm në kërkesën e AK për dokumentet e përshtatëshmëris:

Për të argumentuar edhe më tutje këtë pretendim akimorë në faqën zyrtare të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publike, interpretimi i 6. 22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?. Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston.

Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. O OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. O Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Në praktikën e të gjeturave të Panelit Shqyrtues.

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, rastet si në pretendimin numër 3 ndër të tjera dhe prendime për (VËRTETIMET) ngjajshëm me pretendimin tonë ankimore, se si janë trajtuar rastet e ngjajshme:

Shembull 1: Vendimi OSHP: 2025/0965, ju lutem ti referoni mendimit profesional të ekspertit në këtë lëndë si dhe të gjeturata të PSH

Shembull 2: Vendimi OSHP: OSHP: 2024/1171 ju lutem ti referoni mendimit profesional të ekspertit në këtë lëndë si dhe të gjeturata të PSH

Andaj, bazuar në të thënat dhe argumentet në prenimin 3, kërkojm nga stafi profesional dhe Paneli Shqyrtues që lëndën ta kthej në ri-vendosje duke anuluar vendimin për dhënjë kontratë dhe ofertën e rekomanduar ta shpallni të pa përgjegjshme.

Pretendimi ankimore 4

Në FDT të dosjes së tenderit është kërkuar, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Që operatorët ekonomik të prezantojnë:

Kërkesat për stafin teknik dhe profesional është mundësuar që operatorët e interesuar për këtë projekt të prezantojnë stafin duke argumentuar me listën e deklaramit të të punësuarve në Administratën Tatimore të Kosovës.

Grupi Operatorve Ekonomik ka prezantuar një pjesë të stafit profesional me dëshmi të listës së ATK-së, ndërsa pjesën tjetër të stafit janë prezantuar kontrata punë të cilat janë nën çdo parim ligjorë. Në shumicën nga kontratët e prezantuara elementet thelbësore të tyre si: afatet e kontratave dhe pagat e të punësuarve janë në kundërshtim me aktet ligjore të Ligjit të Punës Nr. 03/L 212, dhe vendimet e pagavave minimale për të argumentuar pretendimin ankimor shih kontratat e prezantuara: Kontrata e punës e prezantuar më poshtë është me titull “Kontrat Punës”, ndërsa në brendësin e saj është thënë edhe një titull “Marrveshje”, që në esencë ky akt juridik nuk përmban as bazën elementare për tu konsideruar si (Kontratë pune apo Marrëveshje) sepse elementet thelbësore si afatet tek është thënë se:

Sipas listës së stafit profesional të bashkëngjitur nga OE-ja fituese shifet qart se inxhinieri i diplomuar i Arkitektures z. Krenar Veseli nuk e plotëson kriterin sipas kushteve të kërkuara nga dosja e tenderit për arsye se nga kontrata e bashkëngjitur shifet se marrëdhënia e punës është themeluar në baze të konkursit apo marrëveshjes të vitit 01.01.2015 e përcaktuar në pikën 2.1 të Kontratës. Si dhe Ligji nr. 04/l-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 17 Lidhja e detyrueshme dhe përmbajtja e detyrueshme e kontratës. Afatet e lidhjes së kontratës nuk përkojnë me afatet për të cilat është parashikuar projekti në fjalë pasi që fati i kontratës është 36 muaj, ndërsa kontrata e cituar më lartë është lidhur në periudhën dy vjeqare.

Edhe Kontrata e Punës e përmban gabimet e njëta duke mos plotësuar elementet thelbësore të kontratës së punës që ka inkorporuar edhe termin “Marrëveshje” që është në kundërshtim me çdo parim për krijimin e marrëdhënies së punës. Ndër, të tjera orari i punës është paraparë që e punësuarja ka një orar prej 4 ore pune në ditë ndërsa 20 orë në javë, duke kalkuluar edhe kohën e pauzës që është parashikuar edhe në pikën 4.2 i bie që orari i punës të jetë 3 orë në ditë. Titulli i kontratës dhe orari i parashikuar janë në kundërshtim me aktin juridik për krijimin e marrëdhënies së punës pasi që çështja në fjalë është e rregulluar me Ligjin e Punës 03/L 212 neni 20 Përcaktimi i orarit të punës paragrafi 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Nisur, nga orari i punës kontrat është dashur të jetë, kontrat e mbështetur në nenin 2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me orar jo të plotë pune, në kohë të caktuar dhe të pacaktuar.

Edhe kjo kontratë punë është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit e në veqanti me rëndësinë e projektit pasi që i punësuarja sipas kësaj kontratë orarin e punës i shënuar më lartë është 9 orë pune që i bie së në minusimin e pauzës i njëjti ka për të punuar më pak se një orë punë apo më thënë sakt në orarin ditorë i bie që të punoj 48 minuta në ditë punë, dhe si element është në

kundërshtim më të gjitha kërkesat si dhe parimet elementeve thelbësore të kontratës së punës. Tituli i kontratës dhe orari i parashikuar janë në kundërshtim me aktin juridik për krijimin e mardhënies së punës pasi që çështja në fjalë është e rregulluar me Ligjin e Punës 03/L 212 neni 20 Përcaktimi i orarit të punës paragrafi 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Ky pretendim nuk është shqyrtuar nga AK në kërkesën për riqyrtim. – Kontrata e punës e lidhur për titullin Injineri i Elektorsë është në kundërshtim me çdo parim ligjore e përmban gabimet e njëta duke mos plotësuar elementet thelbësore të kontratës së punës që ka inkorporuar edhe termin “Marrëveshje” që është në kundërshtim me çdo parim për krijimin e marrëdhënies së punës. E në pjesën thelbësore kontratës tek paga e të punësuarit është shënuar paga 150 euro neto, një vlerë e tillë është në kundërshtim me vendimin e Këshillit Ekonomik e Socila për pagën minimale në vendin tonë sepse paga minimale që nga tetori i vitit 2024 është në shumërn prej 350 euro bruto. Andaj, kjo kontrata nuk është në pajtim me pagën minimale dhe si e tillë është në kundërshtim me aktet ligjore.

Edhe kjo kontratë punë është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit e në veqanti me rëndësinë e projektit pasi që i punësuarit sipas kësaj kontratë orarin e punë i shënuar më lartë është 9 orë pune që i bie së në minusimin e pauzës i njëjti ka për të punuar më pak së një orë punë apo më thën sakt në orarin ditorë i bië që të punoj 48 minuta në ditë punë, dhe si element është në kundërshtim më të gjitha kërkesat si dhe parimet elementeve thelbësore të kontratës së punës. Tituli i kontratës dhe orari i parashikuar janë në kundërshtim me aktin juridik për krijimin e mardhënies së punës pasi që çështja në fjalë është e rregulluar me Ligjin e Punës 03/L 212 neni 20 Përcaktimi i orarit të punës paragrafi 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Për të ju rikujtuar se si keni trajtuar një procedurë çështjen me pagat e të punësuarve ku keni eliminuar nga gara operator pikrisht për: Shih vendimin e zyrtarit te prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi” ne ankesën Nr. 1173/2025 janë parashtruar si në vijim:

I. HYRJE

Në cilësinë e Grupit te Operatorve Ekonomik YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi & “Limit Project” Sh.p.k, në përputhje me nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, 12.11.2025, me të cilin kompania jonë është eliminuar nga procedura e vlerësimit për kontratën : Ndertimin e Objektivit te Spitalit te pergjithshem ne Ferizaj-vazhdimi të kontratës së lartcekur.

Ne nuk pajtohemi me vendimin e Autoritetit Kontraktues:

1. Nuk pajtohemi me vlerësimin e dosjes se tenderit te prezantuar nga ne si konzorcium dhe me arsyen e eliminimit. Elaborimin do ta bejme ne vijim.

2. AK ka shpallur fitues konzerciumin : ADA Consulting Group Shpk, SHM Architecture Shpk, Termo Consing Shpk, ne vleren : 23,992,180.83€, duke mos e trajtuar sipas Nenit 7 – barazia ne vlerësim/mosdiskriminimi, dhe nenet tjera te cilat jane theksuar me lart dhe do te elaborohen veç e veç.

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shendetesise, ne na ka eliminuare me arsyetimin : Grup i OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi, LIMITPROJECT SH.P.K ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 ₺. Projektet e papranueshme të OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi:

Referenca nr.1 e lëshuar nga AIRPORT OPERATION AND AVIATION INDUSTRIES INC. (HEAS) për projektin “Movement Area Maintenance and Repair, 2020/41854”, e datës 17.11.2022, paraqet vlerën e kontratës në shumën 53.438.803,03 TRY- nuk pranohet pasi që nuk hyn në kategorinë e kërkuar ndërtim ose renovim sipas përshkrimit në referencë.

Referenca nr.3 e lëshuar nga GENERAL DIRECTORATE OF STATE AIRPORTS (DHMi) për projektin “GAZIANTEP AIRPORT PARALLEL TAXIWAY RENOVATION, 2019/567456” - nuk pranohet pasi që nuk hyn në kategorinë e kërkuar ndërtim ose renovim sipas përshkrimit në referencë.

Referenca nr.4 e lëshuar nga MEDICINE TEKNOLOJİ VE SAĞLIK YATIRIM A.S. për projektin “Medicine Hospital Construction Work 4 Contractor”, e datës 01.09.2024, paraqet vlerën e kontratës në shumën 282,750,250.00 TRL, e cila sipas dokumentit është ekuivalent me 45,674,865 €.

Pas verifikimit të kursit zyrtar të këmbimit në datën e lëshimit të referencës (01.09.2024), konstatohet se ky ekuivalent nuk përputhet me normat reale të tregut. Në atë periudhë, kursi mesatar i Bankës Qendrore të Turqisë dhe burimeve ndërkombëtare (ECB, ExchangeRates.org) ka qenë rreth (1 TRY = 0.0266 ₺). Duke aplikuar këtë kurs real, shuma e deklaruar prej 282,750,250 TRL konvertohet në 7,521,156.65 ₺, që jo 45,674,865.00 ₺ sig është paraqitur në referencë.

Tendencat e Autoritetit Kontraktues, të paraqesin gjeja se në kemi paraqitur kurs valutor në kundërshtim me realitetin, duke u bazuar në Kohen e përfundimit të kontratës (letres se referencës) dhe jo datës së kontratës, është tendencë për tjetërsim të realitetit dhe tendencë të manipulimit të opinionit publik.

Parimi bazë mbi arsyeshmerinë e kontratës me : Kontrata lidhet sipas kushteve ekzistuese në datën e nënshkrimit . Kjo kontratë nuk është nënshkruar me datë 01.09.2024, por është nënshkruar me datë 18.03.2019, mirepo ka përfunduar me datë 01.09.2024. Praktikisht vlera e liras turke në atë kohë ishte 6.19 dhe tani kjo vlerë është rreth 41/42 Lira për 1 Euro.

Ju si autoritet duke e ditur që keni “ditur të kontrolloni” kurset valutore botërore ju lutem të analizoni datën 18.03.2019 sa ishte vlera e kontratës dhe mbi këtë fakt të na eliminoni ose vlerësoni ofertën tonë si të përgjegjshme.

Mos të harrojmë se: Në të drejtën kontraktore (kombëtare dhe ndërkombëtare), vlera dhe detyrimet kontraktore fiksohen në momentin kur palët bien dakord dhe nënshkruajnë kontratën. Pika e referencës për interpretimin e çmimit është data e nënshkrimit. Në këtë datë, palët kanë llogaritur shkallën e këmbimit, rreziqet financiare, dhe obligimet. Kjo quhet “parimi i përputhjes së vullnetit” (meeting of minds).

Kursi i këmbimit në datën e nënshkrimit është pjesë e marrëveshjes Në kontrata ndërkombëtare, çmimi i deklaruar në një valutë (në këtë rast TRY dhe ekuivalenti në Euro) është: çmimi i

negociuar, çmim i rënë dakord, çmim i pranuar me vetëdije nga të dy palët.

Në momentin e nënshkrimit në mars 2019, palët kanë pranuar se: 282,750,250 TRY = 45,764,865 EUR Ky ekuivalent është pjesë e dokumentit dhe përbën fakt financiar të kontraktuar.

Devaluimi është rrezik i parashikuar dhe i mbartur nga pala që mban valutën e kontratës:

Sipas praktikave ndërkombëtare: Rreziku i luhatjes së valutës nuk ndryshon vlerën e kontratës. Ky rrezik zakonisht i takon operatorit ekonomik ose pales që ka pranuar pagesën në valutën përkatëse. Meqë vlera e kontratës ishte në Lira Turke, por edhe me ekuivalent në Euro, ndryshimi i kursit drejt përfundimit të kontratës nuk e ndryshon detyrimin bazë të autoritetit kontraktues. Prandaj në rastin tone: Vlera e kontratës është dhe mbetet ajo që është nënshkruar në mars 2019: 282,750,250 TRY (? 45,764,865 EUR).

- Devaluimi i mëvonshëm që e bën ekuivalentin 7.5 milion Euro është thjesht ndryshim i tregut, jo ndryshim kontraktual.

- Çdo interpretim i vlerës sipas kursit të përfundimit është i pasaktë juridikisht dhe financiarisht.

Ne vazhdim do ti paraqesim te gjeturat tona per konzerciumin e shpallur fitues.

1. Sipas kërkeses se Dosjes se tenderit, saktësisht tek Fleta e te dhënave te tenderit (FTD), tek Krijimi i nje grupi te operatorve ekonomik, pika 11.1, saktësohet qarte mënyra e krijimit të një grupi te operatorve ekonomik, pika qe duhet t'i përmbahen.

Gjithashtu ne dosje te tenderit ne faqen 22 eshte Aneksi 6 Deklarata per themelim te grupit, i cili anekse duhet te plotësohet qarte nga te gjithë antaret e konzerciumit. Tek konzerciumit i grupit te operatorve ekonomik vërejmë qe konzerciumi i paraqitur nuk i plotëson kërkesën për të qenë një konzercium i pranushem. Vërehet qarte qe tek pjesa Header & Footer Tools eshte ndërhyre, mungojnë te dhënat e tenderit titulli dhe numri i prokurimit. Tek pika “f” thuhet: Ne te gjithë antaret e grupit konfirmojmë pergjegjesit e secilit antare: a) sheno pergjegjesit e Liderit dhe b) sheno pergjegjesit e antarit, dhe nese jane me 7/3 shume se dy antare shto sipas nevojës. Ndersa konzerciumi i paraqitur nga ana e ADA Consulting Group Shpk, SHM Architecture Shpk, Termo Consing Shpk i mungojne pergjegjesit per antaret.

Po ashtu kjo marreveshja ku eshte autorizuar Lideri, nuk dihen datat e autorizimit, pasi qe nuk jane datat e specifikuar. Kjo situatë përbën mospërputhje të qartë me kërkesat e përcaktuara në FDT si edhe me kushtet e tjera të përcaktuara në dosjen e tenderit.

2. Ne momentin e shpalljes fitues te nje OE ose GOE, ju kërkohen deshmi Vertetimi i Gjykates dhe Vertetimi i ATK-se. Por kompania ose antari i konzerciumit “Termo Consing” Shpk kishte marrëveshje me ATK-ne, marrëveshje e cila eshte pas shpalljese se dates se tenderit, marrëveshja eshte e dates 11.06.2025 gje e cila nuk eshte ne perputhshmeri sipas interpretimeve te KRPP-se.

3 Gjate kontrollimit te dosjes se konzerciumit te shpallur fitues nga AK: Ministria e Shendetesise, vërejmë qe nje kontrate e paraqitur nga ta, nuk ka referencen te puneve te kryera per kete projekte. Referenca eshte vetem per punet shtese, qe i bije qe konzerciumi nuk e ka përmbushin kerkese e paraqitur ne FTD tek pika 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, ku duhet te dëshmohet qe jane kryer me sukses projektet te ngjashme te ndertimit ose renovimit ne vleren jo me pak se 35 milion euro te përfunduara ne periudhen e shkuar tre vjeçare. gje qe kete e

ka konstatuar edhe komisioni vlerësues. Kete e ka vlersuar edhe komisioni.

4. Mosperputhje ka tek stafi profesional, inxhinierat e paraqitur nuk figurojn ne listat e ATK se. Kërkesa e dosjes se tenderit ishte qe inxhinierat te jene ne tre mujor e fundit gjate 12 muajve.

Të gjitha këto konstatime dhe prova te bashkangjitura vërtetojnë se Autoriteti Kontraktues: Ministria Shendetesise, ne rastin konkret ne mënyre flagrante ka bere shkelje esenciale te dispozitave te lartcekura te LPP-se. Nga te cekurat me lart i propozojmë Autoritetit Kontraktues: Ministrise se Shendetesise qe Kërkesën për Rishqyrtim ta aprovoj si te bazuar dhe qe i njëjti ta rishqyrtoj vendimin e vet si te gabuar dhe jo te plote dhe te beje përmirësimin e vendimit te vet dhe te kthej lenden në ri-vlerësim duke na rekomanduar ne për shpërblim me kontrate konform formulës se aplikuar nga ana e autoritetit kontraktues, ose ne te kundërtën ne do ti shfrytëzojmë te gjitha mundësitë ligjore ne institucionet ligjore për animim. Ne rast te ndonjë paqartësie ju lutemi mos hezitoni te na kontaktoni me qellim te qartësimi te kërkesës sonë.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues:

Pretendimi ankimor për OSHP: E lusim ekspertin shqyrtues te trajtoj dokumentacionin si vijon: Autoriteti Kontraktues e pranon qe ju kane refereruar kursit te kembimit ne kohen e realizimit te references dhe jo ne kohen e nenshkrimit te kontrates si kohe reale e matjes se vleres se nje kontrate. Theksohet ketu çfarë nese kembimi valutor ishte ne te kundertetn, a do te llogariste Autoriteti Kontraktues kembimin ne ditën e fillimit te kontrates apo ne fund, apo cila do forme qe i ka konvnuar ketij. Paraqesim qe koha reale mbi matjet e vleres se nje kontrate eshte koha e nenshkrimit dhe jo koha e realizimit (pasi qe kursi mundet te mbese i pa ndryshuar) vlera mbetet njesoi, mirepo obligimet kontraktuale lidhen me ditën e kontrates se nenshkruar dhe jo ndryshimet ne te. Nese autoriteti kontraktues ka hasur ne nje dokument te tille qe thekson ne rastin qe ndryshon kursi valutor, ndryshon vlera e kontrates edhe ne mund ta pranojme ate, mirepo arsyeja e eliminimit ishte absurde dhe e pa pranueshme.

Ketu i kerkojme PSH-OSHP qe te analizoi vleren e kontrates, te pyes direkt Operatorin Ekonomik ose direkt Autoritetin Kontraktued dhe te analizoi nese vlera reale e kontrates ishte 45 milione euro apo 7 milione euro sic pretendon autoriteti kontraktues. Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues:

Pretendimi ankimor për OSHP: Deformimi i pergjigjes nga ana e autoritetit kontraktues, jane qellim kqia dhe tendencioze me qellim qe te ngarkojne OSHP-ne me materiale te panevojshme dhe kthimi i pergjigjes te jete jo i matshem. Kriteri mbetet “ZERO” kur per nje ceshtja ka vendosur OSHP dhe KRPP, ne rastin e obligimeve financiare ka vensour KRPP ne pyetet e shpeshta ku thekson: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Paragrafi 5 i nenit 65 te LPP përcakton:

5. Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim. Paragrafi 8 i nenit 26 te RUOPP përcakton: Kërkesa 1. nuk është ne vonese ne pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimit sociale Dëshmia dokumentuese 1. Në lidhje me tatimet një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore të vendit të themelimit që OE nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve të paktën deri në çerekun e fundit të vitit; dhe në lidhje me sigurimin social, një

certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente ose operatorë publik që vërteton se një gjendje e tillë nuk ekziston. Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohe në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohe nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohe dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jete OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jete i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jete i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-ne, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jete para datës së publikimit të njoftimit të kontratës.

Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jete gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë. Nëse mbrohet me kaq fanatizem kriteri nga ana e autoritetit ku thekson që “tremujorin e fundit para dorëzimit” kjo I bje se edhe kriteri ishte I qëllimshëm kur thekson se të njëjtit e kanë ditur që TERMOCONSING nuk e plotëson këtë kriter dhe e kanë vendosur qëllimshëm. Paraqesim se pyetjet e shpeshta të KRPP-se theksojnë dicka tjetër, që BORXHI i OE nuk duhet të jete me marrëveshjen para NJOFTIMIT PER KONTRATE, bazuar në marrëveshjen në mes ATK-se dhe TERMOCONSING kjo marrëveshje është në kundërshtim të plotë me atë që thekson KRPP: Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jete OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jete i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit.

Ketu i kërkojmë PSH-OSHP dhe Ekspertit shqyrtues të trajtojë dokumentacionin mirë, dhe krahas kërkesës sone të paraqes edhe faktet që TERMOCONSING ka obligime tatimore dhe në kundërshtim me shpjegimin e KRPP-se.

Pergjigje nga Autoriteti Kontraktues:

Pretendim ankimor për OSHP: Pergjigja është pergjigje jo e sakte, pergjigje e cila nuk ka asnjë argument, pergjigje e cila thekson asnjë detaj me të cilin vërteton se të njëjtit i plotësojnë kriterin, por është pergjigje shkarazi që ka tendencë të manipulimit të ekspertit Shqyrtues dhe Panelit. Kjo për faktin që edhe në vet raportin e rivlerësimit nga Komisioni vërejmë që ky GOE nuk është i pergjegjshëm:

Si eshte e mundur te shperblehet me kontrate nje GOE i cili sipas komisionit nuk eshte ne pajtim, eshte per qudi se as sistemi kompjuterik i KRPP-se e-prokurimi nuk e lejon nje ceshtje te tille, nese raporti eshte i plotesuar "nuk eshte ne pajtim" kjo i bje se nuk mund te klasifikohet si GOE i pergjegjshem dhe te shperblehet me kontrate, pasi qe nese njeri nga kriteret nuk i ploteson klasifikohet me ngjyre te kuqe dhe nuk e lidh oferten me raportin.

Pergjigje nga Autoriteti Kontraktues:

Pretendim ankimor per OSHP:

Vet pergjigja e Autoritetit Kontraktues thekson ne si OE i kemi pretendimet e bazuara, per faktin qe thekson qe lejohen defektet e vogla, dhe nuk eshte AK autoriteti qe vendos a jane defekte te vogla apo jo, vet faktin qe ajo thekson se nuk ka ndryshime materiale ose devijime me karakteristika apo kushte. Nuk eshte AK autoritet qe verteton a ka devijim te lehte fakti qe nje OE ne kuader te GOE ka obligime ne ATK ne kundershtim me sqarimet e krpp-se numer 64, nuk eshte AK autoritet qe verteton nese ne kemi paraqitur pretendime te vogla, por eshte OSHP.

Andaj i kerkojme PSH-OSHP/se qe kete pretendime ti karakterizoi si te bazuara dhe lenden ta kthej ne rivleresim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Raf II Sh.P.K.," ne ankesen Nr. 1175/2025 jane parashtruar si ne vijim:

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.12.11.2025, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Ada Consulting SHPK&SHM Architecture SHPK&Termo Consing SHPK" me çmim prej 23,992,180.83 €

Ne kem pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë: ARSYETIM Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si ne vijim: Lidhur me kriterin 1 te kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesat mbi mundesite teknike teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 1. OE ose GOE duhet t dëshmoj se ka realizuar me dëshmoi se ka realizuar me sukses nroiekte ts noisishm sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të ndërtim ose renovim, në vlerë të nëroithshme io me nak se përgjithshme jo me pak se tridhietenesë (35) Milion Euro. tridhjetepesë (35) Milion Euro, te përfunduara gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastukurore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe tte ngjashme. Në rast të grupit te oe, së paku 51% e punëve të Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet ti ketä këto todhi ketë këto te dhëna: - Titullin kontratës, - Investitorin, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt te realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve te kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata te pranimit te leshuara nga Kompani AIA përfunduara kërkohet për liderin e grupit. te licencuara - Te autorizuar per këtë qellim ne vendin ku ndertimi eshte realizuar. nderti Per OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare te projekteve private. Ju e keni dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar megjithatë, vlere totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 €.

Data e Njoftimit për Kontratë për këtë aktivitet është 02.04.2025, prandaj pranohet vetëm përvoja e realizuar gjatë periudhës nga 02.04.2022 deri më 02.04.2025. Projektet e papranueshme të OE Raf II sh.p.k: 1. Projekti nr. 1 -Construction of a new Sports Center "Omnisport" (3,811,419.57 €). Referenca e lëshuar më 18.03.2022 nuk hyn në periudhën e kërkuar (pas 2. 3. 4. 02.04.2022). Projekti nr. 5- Construction of Rendering Plant Category I for Animal By-Products Lot 1 & Lot 2 (2,940,401.45 €). Përfunduar në 03.2022 → jashtë periudhës së kërkuar. Projekti nr. 6 - Upgrade of Infrastructure Lot 1 (1,056,351.40 €). Nuk pranohet, pasi që referencat nuk janë të nënshkruara nga autoriteti kompetent. Projekti nr. 7-Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special Shtime (në vazhdim). Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar. Vlera totale e projekteve të realizuara nga OE Raf II sh.p.k. e që janë konform periudhës kohore të përcaktuar në dosje të tenderit, vlera totale e projekteve të pranueshme është 17,624,479.02 €. Projektet e papranueshme të OE Fitorja SH.P.K: Projekti nr. 4- Ndërtimi i Kompleksit banesor Ferizaj Ri Llam. B në Ferizaj, në vlerë 16,888,793,08 €, statusin e ka në vazhdim - Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar, ndërsa kërkesa e tenderit është "...te përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë". Projekti nr. 5- Ndërtimi i Kompleksit banesor Ferizaj Ri Llam. C në Ferizaj, në vlerë 5,715,723.40 €, statusin e ka në vazhdim - Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar, ndërsa kërkesa e tenderit është "...te përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë". Vlera totale e projekteve të realizuara nga OE Fitorja SH.P.K. e që janë konform periudhës kohore të përcaktuar në dosje të tenderit, vlera totale e projekteve të pranueshme është 11,987,620.42 €. Totali i projekteve të pranuar: Fitorja SH.P.K. = 11,987,620.42 € Raf II sh.p.k. =17,624,479.02 € Totali i GOE = 29,612,099.44 € Duke qenë se vlera totale e projekteve të realizuara është 29,612,099.44 €, e cila është më e ulët se kërkesa minimale prej 35,000,000.00 €, Grupi i Operatorëve Ekonomik Raf II sh.p.k. & Fitorja SH.P.K. nuk e përmbush kriterin kryesor nr. 1 të Kapaciteti teknike dhe profesional sipas nenit 9.1 & 9.2 të NJK dhe Dosjes së Tenderit. Kjo arsye e eliminimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme sepse në jo vetëm që e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit por e tejkalojmë vlerën e kontratave të kërkuara. Sa i përket Projektit Nr.1-Construction of a new Sports Center "Omnisport" (3,811,419.57 €), sqarojmë se referenca e bashkangjitur ka qenë për praninë të përkohshme, 5/4 ndërsa në kemi dëshmitë që ua praninë finale është bërë pas 6 muajve dhe tani po bashkangjesim këtë dëshmi- Referencën (e kemi bashkangjitur edhe me kërkesë për rishqyrtim). Nëse ka pasur dilema AK-së është dashur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Sa i përket Projektit Nr.5-Construction of rendering Plant Category I for animal By- Products Lot 1&Lot2 (2,940,401.45 €), sqarojmë se edhe për këtë projekt kemi dëshmi për përfundimin e projektit pas datës së cilës e ka cekur AK-së. Certifikatat e përkohshme të pranimit nuk janë finale, ndërsa tani me ankesë po ua bashkangjesim referencën ku dëshmohet se kjo kontratë është brenda afateve të kërkuara me dosje të tenderit(e kemi bashkangjitur edhe me kërkesë për rishqyrtim).

Sa i përket Projektit Nr.6-Upgrade of Infrastructure Lot 1 (1, 056,351.40 €), se nuk janë të nënshkruara nga autoriteti kompetent, sqarojmë se ky projekt është i nënshkruar nga mbikëqyrësi, dhe kontraktori, mirëpo nëse ka pasur ndonjë dilemë edhe për këtë çështje autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

- Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë grupin e OE "Ada Consulting SHPK&SHM Architecture SHPK&Termo Consing SHPK", ndërsa në kemi kërkuar qasje në dokumente të këtij grupi të OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejt se ky grup është i

papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

- Nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca në vlerë prej 35 milion euro. Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar: Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme.

Në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna: - Titullin kontratës, Investitorin, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të leshuara nga Kompani të licencuara - Të autorizuar për këto qëllime në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do të verifikoj transaksionet bankare të projekteve private.

Ky grup i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar këtë kërkesë, prandaj arsyet dëshmitë për këto mungesa janë të elaboruara më poshtë: dhe

- Kontrata me titull "Ndërtimi Lagjes Priam", Prishtinë e shënuar nga ADA Consulting Group se Vlera e projektit është: 13,414,712.65 €, nuk duhet të merret si e vlefshme pasi që këtë vlerë e ka shënuar vetë Kompania dhe nuk është e shënuar kjo vlerë nga ndonjë institucion që këto investime janë bërë. Pra nuk shkruan vlera as të certifikatave e përdorimit e as tek inspektimi final. Nuk ekziston asnjë dokument zyrtar ku shënohet vlera investive, ndërsa dihet që vlera investive duhet të shënohet ose tek leja ndërtimore, ose të aktvendimi për caktim të tarifës për leje mjedisore komunale ose tek certifikatat e përdorimit. Në kemi pas qasje edhe në dokumentet e kompanive të tjera, e ku kemi vërejt që tek Aktvendimi për caktimin e tarifës për leje mjedisore për kompaninë R&Rukolli është shënuar vlera investive e objektit, ndërsa tek dëshmitë e OE që janë në grupin e OE të rekomanduar për kontratë askund nuk shkruan vlera investive. Për më tepër tek njoftimi i komunës së Prishtinës për inspektim final i dt.01.02.2024 shkruan se dy shtëpi njëra e tipit A37 me etazhitet P+1 dhe tjetra e tipit A38 me etazhitet B+P+1 nuk janë punuar. Kjo do të thotë se ky projekt poashtu nuk është i përfunduar dhe nuk janë ofruar dëshmi se është përfunduar ky projekt, as referencë e as dëshmi të tjera sipas kërkesës.

- Kontrata me titull "Refurbishment of schools- Dardani School- B1 Pristina and Metush Krasnici- Rogocica, Kamenice -B3" e prezantuar me vlerë 2,526,773.12 € nuk duhet të merret parasysh sepse lider i grupit në këtë kontratë është OE Krapo Com SHPK, ndërsa anëtarë të grupit Ada Consulting dhe H&B Consulting dhe nuk dihet se sa është përqindja e realizimit të këtij investimi nga këta tre anëtarë të grupit. Është bashkëngjitur një kontratë ndërmjet palëve ku janë ndarë vlerat mirëpo kjo nuk është e dëshmuar dhe e vërtetuar. Në lidhje me këtë janë bashkëngjitur disa agjenda të takimeve dhe foto, prandaj nuk janë ofruar dëshmi si referenca apo pranime teknike sipas kërkesës.
- Kontrata me titull të projektit "Ndërtimi i objektit afaristo banesore Prishtina ? re", Prishtinë me Vlerë të projektit: 8,087,322.77 € nuk duhet të merret parasysh sepse vlera e projektit nuk shënohet askund në ndonjë dëshmi tjetër përveç se nga vetë Ada Consulting. Gjithashtu në këtë projekt janë dy investitor: NTN Miri SHPK nga Prizreni dhe Ada Consulting Group dhe nuk dihet se me çfarë përqindje janë investitor këto dy kompani.

Edhe për këtë projekt janë bashkëngjitur disa foto dhe një paramasë e pa nënshkruar. Nuk ka dëshmi zyrtare se është përfunduar ky projekt.

- Kontrata me titull "Ndertimi i objektit afaristo banesore Green Avenue", Prishtine me vlerë të shënuar të projektit nga kompania Ada Consulting Group 8,594,901.90 € nuk duhet të merret parasysh sepse vlera e projektit nuk shënohet askund në ndonjë dëshmi tjetër përveç se nga vetë Ada Consulting. Gjithashtu në këtë projekt janë dy investitor: Dardania SH Company SHPK nga Prizreni dhe Ada Consulting Group dhe nuk dihet se me çfarë përqindje janë investitor këto dy kompani. Edhe për këtë projekt janë bashkëngjitur disa foto dhe një paramasë e pa nënshkruar. Nuk ka dëshmi zyrtare se është përfunduar ky projekt. Kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të vlerësojnë drejtë dëshmitë në lidhje me këto kontrata, mungesën e vlerës së investimeve, përqindjen eventuale të realizimit të këtyre kontratave nga anëtarët e grupit. Dosjes Kontrata ndërmjet Termoconsing SHPK me Octacom nuk është sipas kërkesës së tenderit pasi që kjo kontratë ka të bëjë me furnizime me pjesë dhe pajisje termoenergjetike.

- Po ashtu kontrata e lidhur ndërmjet Krapi Com SHPK dhe TermoConsing SHPK ka të bëjë me furnizim të pajisjeve/instalimeve makinerike në objektin e shkollës Dëshmorët e qëndresës në Gllarevë dhe Kuvendi i Lezhës në Viti, prandaj nuk duhet të merret parasysh. Kontrata e lidhur ndërmjet Termo Consing SHPK me Millenium Business Center SHPK ka të bëjë me furnizime. Pra nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit e po ashtu është parashikuar që kjo kontratë të përfundojë me dt.01.06.2025. Referenca është e lëshuar në vitin 2024 dhe aty shkruan se kjo kompani ka qenë si projektuese dhe mbikëqyrëse. Pra ka kundërthënie edhe të datave e edhe të natyrës së kontratës.

- Kontrata e lidhur ndërmjet Termo Consing SHPK me Auto Alberti nuk duhet të merret parasysh sepse nuk është e natyrës së kontratës por ka të bëjë me punë makinerike, prandaj kjo kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Referenca është e lëshuar që ka qenë e angazhuar si projektues dhe mbikëqyrës në zhvillimin e projektit Premium Hospital. Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmitë nga ATK-deklarimet tatimore vjetore ku për Ada Consulting për vitin 2024 figuron se ka qarkullim vjetor 17,147,424.23 € ndërsa humbje deklaror -42,002.30 €. Për vitin 2023 qarkullim vjetor 10,361,967.02 € ndërsa humbje deklaror -14,107.72 € Për vitin 2022 qarkullim vjetor 12,348,168.15 € ndërsa humbje deklaror -21,196.23 €. Si mund të shpallen fitues dhe të nënshkruajnë kontratë kompanitë që operojnë me humbje. Çfarë stabiliteti kanë këto kompani dhe çfarë sigurie mund të ofrojnë për përmbushje të kontratës?

Kërkesa e nenit 8.1&8.2 të FDT-së ka qenë si më poshtë: Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit (2022-2023-2024) ka qenë në vlerë se bashku në të tri vitet jo me pak se dyzetepesë (45) milion Euro. Në rast të grupit të OE, se paku 51% të qarkullimit të plotësohet nga lideri i grupit. OE SHM Architecture SHPK për vitin 2022 qarkullim vjetor 674,306.06 € ndërsa humbje deklaror -431.20 €. Për vitin 2023 qarkullim vjetor 1,359,172.27 € ndërsa humbje deklaror -3,041.01 €. Për vitin 2024 qarkullim vjetor 1,222,949.91 € ndërsa humbje deklaror -451.30 €. OE SHM Termo Consing SHPK për vitin 2022 qarkullim vjetor 2,845,198.05 € ndërsa humbje deklaror 0.00 €. Për vitin 2023 qarkullim vjetor 3,512,903.37 € ndërsa humbje deklaror -20,816.56 €. Për vitin 2024 qarkullim vjetor 2,804,838.42 € ndërsa humbje deklaror -17,069.19 €. Këto statistika që u cekën më lartë e që janë dëshmi nga ATK-ja, vërtetojnë se këto kompani kanë funksionuar me humbje në këto vite që u cekën, ndërsa në anën tjetër kanë prezantuar kontrata milionëshe për ndërtime dhe banesa private por që nuk ka dëshmi që janë deklaruar në prandaj kontratat të cilat i kontestuar

më lartë nuk janë reale me ato të çmimeve të prezantuara dhe kështu nuk duhet të merren parasysh dhe valide. ATK, Këto kompani, madje duhet të hetohen për shmangie eventuale të tatimeve dhe obligimeve financiare ndaj shtetit e jo të shpërblehen me kontratë. Kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të kërkohen sqarime dhe të bëhen verifikime në lidhje me këto dëshmi, në të kundërtën ne do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime në hetuesi dhe prokurori për këto dëshmi të rrejshme dhe për përkrahjen që i është bërë grupit të OE të rekomanduar për kontratë nga ana e autoritetit kontraktues. Qarkullimet financiare kërkohen në dosje të tenderit që të janë pozitive për tu shpallur fitues një kompani apo grup i OE e jo vetëm që të ofrohen si dëshmi pa ndonjë qëllim. Pra qëllimi i kësaj kërkese është të dëshmohet stabiliteti financiar i kompanive, ndërsa në momentin që operon me humbje kompania atëherë si mund ti besohet që mund ta përfundojë një kontratë me vlera kaq të madhe siç është ky tender. Autoriteti kontraktues në raport të vlerësimit e ka cekur se kinse ky grup ka të ofruar kontrata vlefshme në vlerë prej 39,880,160.31 €, mirëpo ky vlerësim nuk është i saktë nëse vlerësohen në detaje dëshmitë e ofruara nga ky grup i operatorëve ekonomik. Gjithashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën në lidhje me kapacitetin financiar, si më poshtë: Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë që mund ti përdori për këtë projekt ose mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti - limit financiar te aprovuar ne emer te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Për OE pretendent per kontratë, para shpalljes si fitues, AK do i vërtetoj dëshmitë e ofruara te gjendjes financiare, a i disponon mjetet e gatshme në bankë ose mbështetjen bankare. Dëshmia 2. Letër konfirmimi nga banka që dëshmon se OE ose GOE ka mjete të gatshme ne 8/4 llogarinë e tijë bankare qe mund ti përdori për këtë projekt ose limit financiar te aprovuar ne emer te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga banka. Sa i përket kësaj kërkese Ada Consulting ka ofruar një letër përkrahje nga NLB Banka ku shkruan se ka të aprovuar limit kreditor, mirëpo nuk ceket se me cilën datë ka të aprovuar limitin dhe se a është shfrytëzuar ky limit apo jo?

Ne dyshojmë shumë se ky limit është i shfrytëzuar dhe për këtë arsye edhe nuk janë kërkuar sqarime nga NLB Banka. Njëjtë shkruan edhe tek letër konfirmimi i ProCredit Bank e ku shkruan njëjtë se në momentin e lëshimit të këtij dokumenti ka të aprovuar limit kreditor. Sa i përket letër konfirmimit nga Procredit Bank, autoriteti kontraktues tek raporti i vlerësimit e ka cekur se ka kërkuar sqarime nga Banka dhe e ka shënuar si më poshtë: Emaili i dërguar nga MSH te Pro Credit Bank me datën 06.11.2025: Te nderuar banka Pro Credit - znj. Lirika Canhasi, Po ju shkruajm nga Ministria e Shendetesise, me qellim te sqarimit te permbajtjes ne dokumentin leshuar nga ana juaj me dt. 21.07.2025. Duke marre parasysh se ne kete dokument nder te tjera eshte sekur si ne vijim: -Leter Konfirmimi me nr. OT-07-2168 ? "Klienti ADA CONSULTING GROUP SHPK në momentin e leshimit te ketij dokumenti, ne Procredit Bank ka te Aprovuar limit kreditor ne shumen Euro 4.000.000.00 (Mbiterhegje Bankare, Linje Kreditore dhe Kredi) te cilat mmond fi perdore per nevoja te biznesit duke pertshire dhe ner prajektin e cekur me larte" per projektin e cekur me larte. Per MSH eshte e rendesishme te vertetohet mbeshtetja financiare e bankes tuaj ne vleren 4 milion euro per kompanine ADA CONSULTING GROUP SHPK per projektin me titull "Ndërtimin e Objektivit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti" me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1 Andaj kerkojme nese keni mundesi dhe ne afate sa me te shpejte, te na konfirmoni me shkrim, se a jane ne disponim mjetet (limiti i aprovuar) ne vleren 4 milion euro dhe a do ta mbeshtetni OE ADA CONSULTING GROUP SHPK ne vleren 4 milion euro, nese i nevoitet per financimin e proiektit me tinll "Ndërtimin e Objektivit te Spitalit te nërgjiithshëm ne Ferizaj- vazhdim nreiekti" me nr prokimi 206-25-80-5-1 projektit me titull "Ndertimin e Objektivit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti" me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1

Përgjigja - Emaili dërguar nga Pro Credit Bank me datën 07.11.2025: Pershendetje zt. Bajraktari, Po shpresoj qe jeni mire dhe punet po ju shkojne mbare. Sa iperket pyetjes suaj lidhur me klientin Ada Consulting Group SHPK, me kete email ne ju vertetojme/konfirmojme qe klienti Ada Consulting Group SHPK, ka limit kreditor te aprovuar ne vlere 4,000,000.00 EURO ne ProCredit Bank. Shumen e mjeteve te lartcekura/limitin kreditor, klienti mund ta shfrytezoj per financim per projektin "Ndërtimi i Objektivit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti" me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1, varesisht nga kërkesa e tij. Cdo te mire, Nga ky komunikim shihet se pyetja është bërë se a janë në disponim mjetet (limiti i aprovuar) në vlerën 4 milion euro, kurse përgjigja nuk ka qenë se mjetet janë në disponim por ka qenë se ka limit kreditor të aprovuar dhe me këtë përgjigje kuptohet qartë se mjetet prej 4 milion nuk janë në dispozicion në momentin kur është bërë pyetja. Me këto dëshmi është dashur të eliminohet grupi i OE të rekomanduar për kontratë. Autoriteti kontraktues ka përdor standard të dyfishtë sa i përket kërkesës për sqarime sepse për dokumentin e lëshuar nga ProCredit Bank kërkon sqarime ndërsa për dokumentin e lëshuar NLB Bank nuk kërkon sqarime.

Grupi i OE "Nika Proing SHPK&&Aktiv SHPK&Anion Mep Contracting është shpallur tenderues i pa papërgjegjshëm nga AK-së, prandaj arsyet e eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Arsyet e eliminimit janë si më poshtë: 9/4 ARSYETI? Oferta juaj është papërgjegjshme për arsyet si ne vijim: Lidhur me kriterin 2 te kërkesat: Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare: Kërkesat mbi gjendjen ekopomike ekonomike dhe financiare 8.1 & Kapaciteti teknik dhe profesional: 8.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj sar se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, duhet të ketë të paktën tetë (8) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën tetë (8) milion Ford milion Euro qasje për kredi në dispozicio?. Për OE pretendent për kontratë, para shpalljes si fitues, AK do i vërtetoj dëshmitë e ofruara nga banka. Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtuc) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej tetë (8) milion EUR, nëse është esee e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Ju keni ofertuar një letër mbështetje të lëshuar nga Raiffeisen Bank, me datë 25 korrik 2025, në emër të OE AKTIV SH.P.K.. Në këtë shkresë banka shpreh gatishmërinë për të mbështetur OE me një kredi në vlerë prej 8,000,000.00 € për implementimin e projektit/tenderit "Ndërtimi i objektit të 10/4 Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti", me Nr. të prokurimit 206-25-80-5-1-1, por me kusht që klienti të plotësojë kriteret dhe kushtet e brendshme të bankës për një kredi të tillë. Duke u bazuar në kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit, ku është specifikuar qartë se OE/GOE duhet të ketë asete likuide në llogari ose qasje për kredi në dispozicion, letra e paraqitur nga banka nuk përmbush kriterin e kërkuar. Arsyeja është se dokumenti i ofruar është i kushtëzuar nuk garanton disponueshmërinë e shumës, por vetëm mundësinë për të marrë kredi nëse plotësohen kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. Si e tillë, kjo letër nuk e plotëson kriterin e lartcekur. Lidhur me kriterin 1 te kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale profesional: 9.1 Kapaciteti teknik dhe 9.2 Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, te përfunduara gjatë periudhës te përfunduara gjatë periudhës sochluar tre viece se shkuar tre vjeçare nga Nioti Njoftimi për Kontrate. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk mesorg pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe te ngjashme. Në rast të grupit te oe, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet ti ketë këto të dhëna: - Titullin kontratës, -Investitorin, -Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimi - Datën e përfundimit të projektit, Vlerë - Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te t pran përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të lëshuara nga Kompani të licencuara - Te autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do të verifikoj transaksionet bankare të projekteve private. Grupi i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO-Ing SH.P.K.; AKTIV SH.P.K.; Anion Mep Contracting ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 € Lideri i grupit OE Anion Mep Contracting e ka ofruar një listë për punët e realizuara, se bashku me kontratat dhe referencat, sipas listës së dorëzuar projektet me nr. rendor 5 dhe 6 nuk janë të pranueshme pasi që nuk janë të përfunduara - JANE NE REALIZIM, Ndërsa projektet në listë me nr. rendor 1, 2, 3 dhe 4, janë projekte ku OE Anion Mep Contracting ka qene i angazhuar si nenkontraktor, ku ka ofruar kontratat e lidhura me OE Generic Engineering Technologies & Contracting W.L.L dhe Sigma Contractinf & Trading W.L.L dhe referencat ? lëshuara nga këta dy OE Ekonomik. Bazuar në kriterin e lartcekur për projektet e realizuara për investitorë privatë, është e domosdoshme paraqitja e certifikatës së pranimit nga komuna ose certifikatave të pranimit të lëshuara nga kompani të licencuara e të autorizuar në vendin ku është kryer ndërtimi. Këto dokumente nuk janë ofruar nga lideri i GOE, marr parasysh që është i papërgjegjshëm edhe për çështjen e përkrahjes nga banka, nuk kemi kërkuar sqarime shtese në këtë pikë. Grupi i OE "R&Rukolli&Limora SHPK&Valmir Loshi B.I është shpallur tenderues i pa papërgjegjshëm nga AK-së, prandaj arsyet e eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Arsyet e eliminimit janë si më poshtë: 11/4 Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim: Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë, është konstatuar se Marrëveshja e Konzorciumit nuk është plotësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Në Dosjes së Tenderit të Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD) të nenit 19.1 (h) është kërkuar: Dokumentet që përbejnë Tenderin 19.1(h) Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimin të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Operatore e Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do të përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet të kryej lideri i grupit në emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 6 është obligativ për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup. Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë vetëm dokumentet e kërkuara në NJK dhe DT. Ky formular, i vendosur në Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, është obligativ dhe operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë vetëm dokumentet e kërkuara në NJK dhe DT, pa i ndryshuar ato. Në formularin e Marrëveshjes në Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, është specifikuar se në vijim: a. Në të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është b. a) [Shëno% (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së Liderit] b) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së anëtarit] Shto sipas nevojës Në të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar: a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit] b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit] Shto sipas nevojës.... Në marrëveshjen e dorëzuar nga ana juaj si grup nuk janë plotësuar të dhënat bazike të kërkuara në formular, si për qindja e pjesëmarrjes së secilit anëtar dhe përcaktimi i përgjegjësive të tyre. Kjo bie ndesh me nenin 44.3 të Rregullores Nr. 001/2022, sipas të cilit formularët standard nuk mund të ndryshohen në përmbajtje dhe nuk lejohet fshirja apo lënia e zbrastet e elementeve të përcaktuara nga autoriteti

kontraktues. a) [Shëno% (përgindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratë se Liderit] b) [Shëno% (përgindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratë e anëtarit] Shto sipas nevojës.... f. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar: g h a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit] b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit] Shto sipas nevojës No tetithë anëtarëve Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE. Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me anëtarin e mbetur, nëse anëtari i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Marrja Emri i Operatorit Ekonomik (lider) R& RukolliSHdertimo Emri Mbiemri Rrustem Rukolli 12/4 Grupi i OE "Teskon Proses Degerli adenler Fonansal Danismanlik LTD.ST&Fidola SHPK" është shpallur tenderues i pa papërgjegjshëm nga AK-së, prandaj arsyet e eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Arsyet TIC e eliminimit janë si më poshtë: Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si ne vijim: Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës tuaj është konstatuar se Marrëveshja e Konzorciumit nuk është plotësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Në Dosjes së Tenderit te Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TE Tenderit (FTD) te neni 19.1 (h) është kërkuar: Dokumentet qe përbejnë Tenderin 19.1(h) Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimin të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Operatorët torët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do të përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si të cilin anëtarët do të përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet të kryej lideri i grupit në emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 6 është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup. Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë vetëm dokumentet e kërkuara në NJK dhe DT. Ky formular, i vendosur në Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, është obligativ dhe operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë vetëm dokumentet e kërkuara në NJK dhe DT, pa i ndryshuar ato. 13/4 Në marrëveshjen e dorëzuar nga ana juaj si GOE është fshirë rubrika për caktimin e përfaqësuesit të autorizuar në Aneksin 6 DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT, duke mos e emëruar personin e autorizuar, e qe bie në kundërshtim me nenin 44.3 të Rregullores Nr. 001/2022 citoj: 44.3 Qellimi i dokumenteve standarde është që të ndihmojnë Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apono kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të nërcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania oë bin deklaraten k kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaraten k? të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes,header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde. Oferta juaj eshte e papërgjegjshme edhe për piken tjetër: Lidhur me kriterin 1 të kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: 9.1 Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare 9.2 Kërkesat mbi Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo më pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës Euro, të përfunduara gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna: - Titullin kontratës, Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e - Investitorin, -Të dhënatë personit - Të dhënat e

personit kontaktues, mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore tërësore, u projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme. Në rast të grupit të oë, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. - Datën e përfundimit të projektit, -Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të lëshuara nga Kompani të licencuara - Te autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar Per OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare të projekteve private. Ju këni dorëzuar Listën e projekteve të realizuara, origjinal, të vulosur dhe të nënshkruar, duke marrë nënshkrimin nga të dhënat e kërkuara (titulli i kontratës, investitori, të dhënat e personit kontaktues, data e përfundimit, vlera e projektit) si dhe ka bashkëgjetur referencat për punët e kryera mirëpo nuk ka ofruar:

Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të lëshuara nga Kompani të licencuara - Te autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për projektet me investitor privat nuk janë dorëzuar paramasa e punëve të kryera dhe certifikatat e pranimit nga komuna ose nga kompani të licencuara dhe të autorizuar në vendin ku është realizuar ndërtimi, marrë parasysh se ka qene i papërgjegjshëm administrativisht nuk kemi kërkuar sqarime shtese.

? Grupi i OE "Ybt Insaat ve Ticaret Limited Sirketi&Limit Project SHPK" është shpallur tenderues i pa përgjegjshëm nga AK-së, prandaj arsyet e eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Arsyet e eliminimit janë si më poshtë: Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si ne vijim: Lidhur me kriterin 1 të kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: 14/4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo më pak se tridhjetepesë (35) Milion (35) Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastruktur infrastrukturore, rrugë, ura, niësiollës kanalizime dhe të ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme. Në rast të grupit të oë, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe të nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna: - Titullin kontratës, - Investitorin, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të lëshuara nga Kompani të licencuara - Te autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare të projekteve private. Grupi i OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi, LIMITPROJECT SH.P.K ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 €. Projektet e papranueshme të OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi: Referenca nr.1 e lëshuar nga AIRPORT OPERATION AND AVIATION INDUSTRIES INC. (HEAS) për projektin "Movement Area Maintenance and Repair, 2020/41854", ? datës 17.11.2022, paraqet vlerën e kontratës në shumën 53.438.803,03 TRY- nuk pranohet pasi që nuk hyn në kategorinë e kërkuar ndërtim ose renovim sipas përshkrimit në referencë. Referenca nr.3 e lëshuar nga GENERAL DIRECTORATE OF STATE AIRPORTS (DHMI) për projektin "GAZIANTEP AIRPORT

PARALLEL TAXIWAY RENOVATION, 2019/567456" - nuk pranohet pasi qe nuk hyn ne kategorinë e kërkuar ndërtim ose renovim sipas përshkrimit ne reference. Referenca nr.4 e lëshuar nga MEDICINE TEKNOLOJI VE SAGLIK YATIRIM A.S. për projektin "Medicine Hospital Construction Work - Contractor", c datës 01.09.2024, paraqet vlerën e kontratës në shumën 282,750,250.00 TRL, e cila sipas dokumentit është ekuivalent me 45,674,865 €. Pas verifikimit të kursit zyrtar të këmbimit në datën e lëshimit të referencës (01.09.2024), konstatohet se ky ekuivalent nuk përputhet me normat reale të tregut.

Në atë periudhë, kursi mesatar i Bankës Qendrore të Turqisë dhe burimeve ndërkombëtare (ECB, ExchangeRates.org) ka qenë rreth (1 TRY \approx 0.0266 €). Duke aplikuar këtë kurs real, shuma e deklaruar prej 282,750,250 TRL konvertohet në 7,521,156.65 €, e jo 45,674,865.00 € siç është paraqitur në referencë. 15/4 Kursi i këmbimit Lira/Euro: 1 TRY = 0.0266 EUR (Burim: ExchangeRates.org.uk -TRY/EUR Historical Rates 2024) September 2024 Date Sunday 1 September 2024 Turkish Lira to Euro Link to Date £1 TRY = €0.0266 TRY/EUR rate for 01/09/2024 Llogaritja: 282,750,250 TRY x 0.0266=7,521,156.65 € Diferenca prej më shumë se 38 milionë € tregon qartë mospërputhje dhe vë në dyshim saktësinë dhe besueshmërinë e dokumentit. Dokumenti i paraqitur nuk pasqyron kursin zyrtar të këmbimit në datën e lëshimit dhe kjo mund të verifikohet në mënyrë të besueshme nga burime të pavarura financiare, sistemi ExchangeRates.org.uk. Për shkak të këtij devijimi të madh ne mes kursit real dhe atij të prezantuar, vlera e prezantuar ne reference nuk mund të pranohet si provë e vlefshme për përmbushjen e kërkesës së aktivitetit të prokurimit, meqenëse ka dallim shume te madhe me vlerën reale te konvertimit ne atë kohe. Kriterin 1 te kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qene se në rast të grupit te OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit, qe ne këtë rast nuk OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi nuk e mbërrin vlerën e kërkuar për punët e kryera po ashtu edhe anëtarin e konsorciumit LIMITPROJECT SH.P.K si anëtar i grupit nuk ka arritur te dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë e kërkuar. Grup i Operatorëve Ekonomik AK INVEST DOOEL Tetovo&HIDRO PROJECT SH.P.K.; Benita Company&ENGRUP SH.P.K., Maqedoni, është i papërgjegjshëm, mirëpo autoriteti kontraktues e ka shpall të përgjegjshëm. Është shumë i çuditshëm fakti se për këtë grup të OE janë kërkuar sqarime dhe pse ky është shumë më i shtrenjtë se sa grupi i OE të rekomanduar për kontratë. Siç duket autoriteti kontraktues ka përdor dhe përgatitur dy variante për shpallje të fituesit, një ky që tani është shpall dhe opcioni i dytë nëse kthehet lënda në rivlerësim ta shpall këtë grup të OE të rekomanduar për kontratë edhe pse ky grup është i papërgjegjshëm. • Nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca në vlerë prej 35 milion euro. Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar: Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, te përfunduara gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe te ngjashme. Në rast të grupit te oe, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet ti ketë këto te dhëna: - Titullin kontratës, - Investitorin, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt te realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve te kryera, certifikata e pranimet nga 16/4 komuna ose Certifikata te pranimet te leshuara nga Kompani te licencuara - Te autorizuar per kete qellim ne vendin ku ndertimi eshte realizuar. Per OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare te projekteve private. Kontratat e anëtarit të grupit Benita Company asnjëra nuk janë sipas kërkesës së dosjes së

tenderit, prandaj nuk duhet të merren parasysh. Në disa referenca lider është Euro Project, madje ka referenca që janë në emër veç të Europrojectit, e që dëshmohet se Benita nuk ka kryer asnjë punë në këto kontrata. Gjithashtu kontratat e prezantuara në listë nga OE Hidro Project nuk janë të natyrës së kërkuar në dosje të tenderit, prandaj nuk duhet të merren parasysh këto kontrata. Grupit të OE të rekomanduar për kontratë i kanë kërkuar sqarime pa ndonjë arsye sepse ky grup i OE ka qenë i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht. Listës së kontratave të OE AK Invest DOOEL nuk i janë bashkangjitur referencat, paramasat etj, ndërsa me sqarime kanë ofruar disa dëshmi që nuk janë përsëri sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Për projektin me nr.2, 3, 5, 6 dhe 10 nuk ka certifikatë të pranimit, prandaj nuk mund të merren parasysh këto kontrata. - Sigurimi i tenderit është bërë nga anëtari i grupit Hidro Project, prandaj ky grup është i papërgjegjshëm. Sigurimi i tenderit duhet të bëhet nga lideri dhe tashmë OSHP-ja ka lëshuar vendime ku ka konfirmuar papërgjegjshmërinë e grupeve ofertuese kur sigurimi i tenderit nuk është bërë nga lideri i grupit. Në këtë grup të OE lider është AK INVEST DOOE Tetovo. - Letër konfirmimet nga Banka nuk janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që Letër informimi nga Banka SPARKASSES dhe STOPANSKA BANKA AD-Skopje janë dokumente deklaruese ku thuhet se nuk është garancion i bankës. - Linja kreditore nga Komercijalna Banka nuk është sipas kërkesës sepse aty shkruan se nëse plotësohen kushtet sipas kritereve të Bankës. Të gjitha këto mangësi e bëjnë të papërgjegjshme ofertën e këtij grupi ofertues. Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.21.11.2025, i cili vendim është po ashtu i kundërligjshëm. Përgjigja e AK-së në pretendimet tona ankimore ka qenë si më poshtë:

Përgjigjet e AK ne lidhje me pretendimin ankimor te oe Raf II Shpk Sa i përket pretendimit ku ju si oe ankues i keni kontestuar arsyet e eliminimit tuaj për shkak te mos plotësimit te vlerës se kërkuar 35 milion euro projekte ne tre vitet e fundit. Konsiderojme se ky pretendim eshte i pa bazuar duke marre parasysh kerkesen e tenderit: Për çdo projekt te realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale). Ne momentin qe ju ne oferten e juaj I keni ofruar pranimet teknike me data jashta tri viteve te fundit si është kerkuar, komisioni vleresues nuk e ka pare te arsyeshme te kerkoj dokument shtese. Ndersa sikur te ishte kriteri pranime teknike finale, atëherë ne nuk do e merrnim për baze pranimin e përkohshëm por do ua kërkonim pranimin final. Sa i përket pretendimit ku ju si oe ankues e keni kontestuar vlerën e referencave te ofertes rekomanduar, sipas jush nuk arrihet vlera e kërkuar 35 milion euro projekte ne tre vitet e fundit. se Konsiderojme se ky pretendim eshte i pa bazuar duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka ofertuar me listen e projekteve ne vlore tete pergjit pergjithshme prej 48,549,858.97 €, ndersa bazuar ne vleresimin e komisionit vleresues ne perberje prej dy inxhinierëve dhe nje juristi me kualifikim te larte (me graden e jurispodences), vlera e projekteve te realizuara dhe te kompletuara me dokumentacion përkatës sipas kërkesës arrijnë vlerën: 39,880,160.31 €, qe e tejkalon kërkesën e tenderit prej 35 milion euro. Sa i përket pretendimit per Deklaratat bankare te ofruara nga OE i rekomanduar per mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti. Konsiderojme se ky pretendim eshte i pa bazuar, duke marre parasysh se deshmite e ofruara nga OE i rekomanduarar ee tejkalojne kerkesen e tenderit. Ne kemi kerkuar vetem vërtetim bankar (shënim premtues), ndersa OE i rekomanduar I ka ofruar Letër Konfirmim me Limitt tete aaprovuar nga dy bankat (Pro Credit Bank dhe NLB) me nga 4 milion euro secila, ne total 8 milion, sipas kerkeses me poshte te NJK dhe DT: Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej tetë (8) milion EUR, nëse është e nevojshme. Data ? deklarates bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Gjate vleresimit te ofertave eshte vertetuar vertetimi te Pro Credit Bank, ndërsa për NLB sipas përshkrimit ne Letër Konfirmim nuk eshte pare e nevojshme.

Ndërsa sa i përket konstatimit tuaj se ofertat tjera me te lira lira se ju me te drejte janë eliminuar nga AK, me këtë edhe ne pajtohemi dhe qëndrojmë pas njoftimeve - Letrave standarde për tenderuesit e eliminuar te datës 12.11.2025.

Ne baze te sqarimeve te lartcekura, mund te konkludojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara dhe ne si AK kemi vepruar drejte duke e shperblyer me kontrate oferten e pergjegjshme, njekohesisht duke e ruajtur buxhetin e shtetit meqense kemi shperblyer me kontrate oferten per rreth 2.5 milion me te lire se sa oferta juaj. Në lidhje me arsyen tonë të eliminimit autoriteti kontraktues është shmangur të jep përgjigje në lidhje me dëshmitë dhe faktet të cilat ia kem bashkëngjit përkitazi me kontratat dhe referencat e procesverbalet e pranimeve teknike përfundimtare, prandaj nga kjo përgjigje e mangët kuptohet se autoriteti kontraktues nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore raport me përgjegjshmërinë e ofertës tonë. Në lidhje me pretendimin tonë ankimor se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar vlerën e kontratave ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, autoriteti kontraktues si përgjigje në këtë pretendim sqaron se çfarë kualifikime ka pasur komisioni vlerësues. Ne nuk kemi kontestuar kualifikimet e komisionit vlerësues por kemi kontestuar vlerësimin subjektiv të tyre dhe të ZPP, prandaj kjo përgjigje nuk ka argumentuar asgjë dhe nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore se grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Nuk kemi pranuar asnjë përgjigje në lidhje me pretendimet tona ankimore ku i kemi kontestuar kontratat me titull të grupit të OE të rekomanduar për kontratë. Sa i përket pretendimit tonë ankimor se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën në lidhje me letër konfirmimin nga Banka, autoriteti kontraktues është përgjigjur se është vërtetuar vërtetimi i Procredit Bank ndërsa letër konfirmimi nga NLB Banka nuk është parë e nevojshme të vërtetohet. Nga ky veprim i AK-së kuptohet subjektivizmi i përdorur. Për neve është shumë e paqartë përse është pa e nevojshme të kërkohe sqarime nga ProCredit Bank e nuk është pa e arsyeshme dhe e nevojshme të kërkohe sqarime nga NLB Banka, e po ashtu këtë fakt nuk e ka sqaruar autoriteti kontraktues.

Gjithashtu autoriteti kontraktues e ka shtrembëruar kërkesën në lidhje me letër mbështetjen nga Banka duke insistuar se është kërkuar vetëm një shënim premtues mirëpo ky konstatim i AK-së është i pa saktë dhe jo i vërtetë, sepse dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë si më poshtë: Dëshmia 2. Letër konfirmimi nga banka që dëshmon se OE ose GOE ka mjete të gatshme në llogarinë e tijë bankare që mund ti përdori për këtë projekt ose limit financiar te aprovuar emer te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga banka. ne Pra është kërkuar mjete të gatshme ose limit të aprovuar, prandaj këtë kërkesë nuk e ka plotësuar grupi i OE të rekomanduar për kontratë dhe për këtë arsye është dashur të eliminohet. Autoriteti kontraktues edhe në përgjigjet në pretendimet ankimore ka qenë e njëanshme dhe ka favorizuar grupin e OE të rekomanduar për kontratë, ku në disa pretendime nuk ka dhënë përgjigje të drejtpërdrejta por është shmangur, kurse në disa të tjera ka dhënë përgjigje jo të drejta dhe jo në harmoni me dëshmitë dhe faktet e prezantuara. Të gjitha këto dëshmi të cilat i prezantuar janë argumente të qarta se grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe nëse nuk trajtohen si duhet edhe nga OSHP-ja pa dashur që të kuptohet si presion ky paralajmërim, ju njoftojmë se ne do ti parashatrojmë të gjitha këto dëshmi edhe në hetuesi dhe prokurori dhe nuk do të lejojmë abuzimin e mëtutjeshëm të autoritetit kontraktues dhe të çdo zyrtari me të drejtën tonë Nga këto dëshmi që u cekën më lartë rezultojnë se ne jemi eliminuar padrejtësisht dhe po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, e po ashtu edhe OE tjerë ofertues më të lirë janë të papërgjegjshëm, prandaj ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së.

Nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së autoriteti kontraktues e ka shfrytëzuar në mënyrë jo të drejtë dhe diskriminuese në raport me kompaninë tonë, pasi që nuk ka kërkuar sqarime nga ne edhe pse ne jemi ofertues më i lirë se sa oferta e grupit "AK INVEST DOOEL Tetovo&HIDRO PROJECT, ndërsa nga ky grup ka kërkuar sqarime edhe pse është me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë dhe oferta e grupit të rekomanduar për kontratë. SH.P.K.; Benita Company&ENGRUP SH.P.K., Maqedoni Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet e lartcekura kuptohet që nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse është i papërgjegjshëm, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NIKA PrO – Ing Sh.P.K.," ne ankesën Nr. 1182/2025 janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues (AK), përkatësisht Komisioni Vlerësues, gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë, nuk ka vepruar në harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe me dispozitat përkatëse ligjore të lartcekura, Rregulloren dhe Udhëzimin Operativ për Prokurimin Publik.

AK, përmes Zyrës së Prokurimit, me datë 12.11.2025 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin na ka eliminuar neve, ndonëse jemi ofertues të përgjegjshëm, duke rekomanduar për kontratë një Grup Operatorësh Ekonomik (GOE) të papërgjegjshëm.

Ne, si GOE pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, i kemi plotësuar në tërësi të gjitha kriteret kualifikuese dhe kriteret vlerësuese ashtu siç janë specifikuar në Dosjen e Tenderit, madje edhe duke i tejkaluar ato.

Në përputhje me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës, të cilën AK e ka aprovuar dhe na ka ofruar qasje në dokumentacion.

Gjatë analizimit të dokumentacionit të ofruar nga GOE i rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se i njëjti është totalisht i papërgjegjshëm dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Mund të konstatohet se gjatë procedurës së vlerësimit të tenderëve, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat procedurale dhe materiale të LPP-së, pasi që gjatë

mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, si dhe me dispozitat ligjore që rregullojnë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë në procesin e vlerësimit.

Pas nxjerrjes së këtij vendimi, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, e dorëzuar me datë 17.11.2025, ndërsa refuzimin e kësaj kërkesë e kemi pranuar me datë 21.11.2025.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk pasqyron gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Madje, në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar vetë se OE i rekomanduar për kontratë është me vonesë në pagimin e tatimeve, për faktin se oferta është dorëzuar me datë 25.07.2025, ndërsa marrëveshja me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) është e datës 11.06.2025. Kjo nënkupton se OE në fjalë ka qenë me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar secilin nga pretendimet tona ankimore, të cilat do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërtetohet qartë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 – Kërkesat e përshtatshmërisë së OE: Vërtetimi i ATK-së

Anëtari i konsorciumit nuk ka arritur të plotësojë kriterin e kërkesës për vërtetim të ATK-së pa obligime, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

GOE i rekomanduar për kontratë është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Argumentimi ynë

Arsyeya ligjore për eliminimin e këtij GOE nga ky aktivitet i prokurimit:

Anëtari i konsorciumit, Termo Consing Sh.P.K., nuk ka arritur të plotësojë kriterin e kërkuar për vërtetim të ATK-së pa obligime, në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht nenin 65 dhe nenin 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar.

Mospërputhshmëria me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë

Në kërkesat e përshtatshmërisë për operatorin ekonomik është kërkuar:

Vërtetim i ATK-së pa obligime tatimore; ose

Vërtetim me marrëveshje për shlyerjen e borxhit, me kusht që marrëveshja të jetë e datës para publikimit të Njoftimit për Kontratë, në përputhje me LPP-në dhe interpretimin zyrtar të KRPP-së.

OE Termo Consing Sh.P.K. ka ofruar:

Vërtetimin e ATK-së Nr. 1001296135, i cili dëshmon qartë se OE ka obligime tatimore dhe marrëveshje aktive për shlyerjen e borxhit;

Marrëveshjen me ATK-në të datës 11.06.2025, me nr. protokollin 3535.

Kjo marrëveshje është lidhur pas datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë, dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me LPP-në, pasi që OE nuk ka qenë i pranueshëm në datën e publikimit të njoftimit, ashtu siç kërkohet shprehimisht me ligj.

Baza ligjore – Neni 65 dhe interpretimi zyrtar i KRPP-së

Sipas nenit 65, paragrafi 4.8 i LPP-së:

“Operatori ekonomik nuk duhet të jetë aktualisht me vonesë në pagimin e tatimeve...”

Interpretimi zyrtar i KRPP-së sqaron se:

Termi “aktualisht” nënkupton gjendjen në datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë;

OE duhet të dëshmojë, përmes vërtetimit të ATK-së, se nuk është në vonesë në këtë datë;

Në rast se OE ka marrëveshje me ATK-në, ajo duhet të jetë lidhur para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Qëllimi i kësaj dispozite është që operatori ekonomik të jetë gjithmonë i pranueshëm dhe të mos ketë obligime të pashlyera në momentin e publikimit të njoftimit për kontratë.

Në rastin konkret

Marrëveshja e paraqitur nga Termo Consing Sh.P.K. është lidhur pas publikimit të Njoftimit për Kontratë, dhe si e tillë nuk e plotëson kriterin ligjor për pranueshmëri.

Përfundimi juridik

Bazuar në:

Nenin 65 (par. 4.8 dhe par. 5) të LPP-së;

Nenin 87, paragrafi 2, nënparagrafi 2.8;

Interpretimin zyrtar të KRPP-së;

Kërkesat e Dosjes së Tenderit për vërtetim nga administrata tatimore se OE nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit;

Provën e ofruar nga OE (vërtetim me obligime dhe marrëveshje të lidhur pas datës së publikimit të njoftimit);

Arrijmë në përfundimin se OE Termo Consing Sh.P.K. nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe nuk ka qenë i pranueshëm në datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

OE në fjalë ka qenë me vonesë në pagimin e tatimeve edhe deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit, prandaj nuk e plotëson kriterin e ATK-së dhe, si rrjedhojë, i gjithë

konsorciumi duhet të konsiderohet i papërshtatshëm dhe i pakualifikuar.

Ky kriter përbën kërkesë të detyrueshme dhe mosplotësimi i tij paraqet arsye automatike për eliminim nga procedura e prokurimit, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Konform Ligjit për Prokurimin Publik, marrëveshja me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për shlyerjen e borxheve duhet të jetë e lidhur para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Citojmë sqarimin e KRPP-së:

“Nisur nga fakti se shumë operatorë ekonomikë kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jenë të lidhura para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë.”

Shihni datën e marrëveshjes me ATK-në

Shih pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit: Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomikë

a) Për situatën e referuar në pikën 6.3 [h – tatimet], kërkohet vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Përsëri theksojmë se Autoriteti Kontraktues, në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, e ka pranuar edhe vetë se OE i rekomanduar është me vonesë në pagimin e tatimeve, për faktin se oferta është dorëzuar me datë 25.07.2025, ndërsa marrëveshja me ATK-në është e datës 11.06.2025. Kjo do të thotë se OE në fjalë ka qenë me vonesë në pagimin e tatimeve edhe deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Edhe një herë theksojmë se GOE i rekomanduar për kontratë, marrëveshjen me ATK-në për shlyerjen e obligimeve e ka lidhur pas publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe, njëkohësisht, ka qenë në vonesë në pagimin e tatimeve deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit, çka përbën shkelje të skajshme të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ekziston një fakt thelbësor dhe i pamohueshëm se Grupi i Operatorëve Ekonomikë i rekomanduar për kontratë është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Në këtë rast, edhe nëse Komisioni i Vlerësimit ka bërë një gabim, zyrtari përgjegjës i prokurimit është personi kompetent për të miratuar ose refuzuar rekomandimin, dhe për këtë arsye mban përgjegjësi të plotë për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm. Pra, vonesa në pagimin e tatimeve deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit është fakt objektiv që as Komisioni i Vlerësimit dhe as Zyra e Prokurimit Publik nuk mund ta anashkalojnë pa cenuar ligjin.

Ky është një shembull tipik i favorizimit të paarsyeshëm dhe vlerësimit selektiv, i cili kompromenton të gjithë procesin e Prokurimit Publik dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të ardhshme.

Si përfundim, GOE i rekomanduar për kontratë është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 2 – GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për shkak të mungesës së deklaratës së garancionit

Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit – ANEKS 1:

“Nuk e kemi konsideruar të drejtë të poentohet garancioni i kryerjes së punëve me peshë në përqindje (%), përderisa punët e vrazhda janë kryer nga punëkryesi paraprak, dhe kemi konsideruar se është më e drejtë të kërkohet garancioni i punëve prej 24 muajsh nga data e pranimit të përkohshëm të punëve të përfunduara deri në pranimin final.”

Argumentimi ynë

GOE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues, pasi nuk ka ofruar deklaratën për garancionin e punëve prej 24 muajsh, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, përkatësisht në ANEKSIN 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Edhe ky element përbën kërkesë të detyrueshme dhe mosplotësimi i tij paraqet arsye automatike për eliminim, sipas kriterëve të qarta të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në këto rrethana, operatori i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të paplotë dhe të pakualifikueshme, ndërsa Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit, në kundërshtim të plotë me ligjin, kanë bërë vlerësim të padrejtë dhe kanë rekomanduar për kontratë një ofertë që nuk do të duhej as të kalonte fazën e verifikimit administrativ.

Ekziston një fakt thelbësor dhe i pamohueshëm se Grupi i Operatorëve Ekonomikë i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën për garancionin e punëve prej 24 muajsh, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në këtë rast, Komisioni i Vlerësimit ka bërë një gabim duke rekomanduar një ofertë të paligjshme. Pra, mungesa e deklaratës për garancionin e punëve, sipas kërkesës së përcaktuar në ANEKSIN 1 të Dosjes së Tenderit, është fakt objektiv që as Komisioni dhe as Zyra e Prokurimit Publik nuk mund ta anashkalojnë pa cenuar ligjin.

Edhe ky është një shembull tipik i favorizimit të paarsyeshëm dhe vlerësimit selektiv, i cili kompromenton të gjithë procesin e Prokurimit Publik dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të ardhshme.

Për këtë arsye, edhe për këtë pikë, GOE i rekomanduar duhet të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 3 – Eliminimi i padrejtë i kompanive tona lidhur me letrën e konfirmimit nga banka

Nuk pajtohem me eliminimin tonë për këto arsye:

Dokumentet e dorëzuara nga ne lidhur me mbështetjen bankare janë plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Në dokumentin “Letër Konfirmimi” të ofruar nga anëtarët e konsorciumit, mbështetja bankare është në përputhje të plotë me kërkesën e AK-së, ku kërkohet:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

“OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka mundësi financiare për financimin e kontratës dhe duhet të ketë së paku tetë (8) milionë euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose së paku tetë (8) milionë euro qasje për kredi në dispozicion.”

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

“Dëshmia 2 – Letër konfirmimi (deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milionë eurove në llogarinë bankare të kompanisë ose një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej tetë (8) milionë eurosh, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe duhet t’i referohet aktivitetit në fjalë.”

Argumentimi ynë

Ne kemi dorëzuar pikërisht dokumentin e kërkuar, ku banka konfirmon se, në rast të shpërblimit me kontratë, do të sigurojë mbështetjen financiare në vlerën e nevojshme për ekzekutimin e projektit, duke përmbushur plotësisht kërkesën e përcaktuar nga AK-ja.

Për më tepër, në kërkesën e AK-së thuhet “nëse është e nevojshme”, ndërsa ne këtë projekt mund ta realizojmë edhe me kapacitetet tona financiare, pa pasur nevojë për mbështetje bankare, pasi brenda GOE-së sonë janë të përfshira kompani me renome ndërkombëtare në fushën e ndërtimit, të cilat posedojnë kapacitetet dhe mjetet e nevojshme financiare, çka e kemi dëshmuar në ofertën tonë.

Pavarësisht se kemi dëshmuar se posedojmë mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e projektit, ne kemi respektuar kërkesën e AK-së dhe kemi ofruar edhe letrën e konfirmimit nga banka me premtim për mbështetje financiare.

Ky eliminim përbën shkelje flagrante të parimeve të barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe bie ndesh me nenin 6 të po këtij ligji, i cili kërkon respektimin e integritetit të procesit dhe vlerësimin vetëm në bazë të kriterëve të dokumentuara.

Ky eliminim është i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe i mbështetur në arsytetime të paarsyeshme dhe joproporcionale, në kundërshtim me praktikën e mirëfillta të prokurimit publik.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 4 – Eliminimi i padrejtë lidhur me kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe profesionale

Nuk pajtohem me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mospërbushjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale, pasi jemi në përputhje të plotë dhe madje i tejkalojmë kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1172, i cili është dorëzuar me datë 19.12.2025

Lidhur me pretendimet e OE INVEST DOOEL Tetovo., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1172 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti” me nr. të prokurimit: "206-25-80-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12/11/2025.

Grupi i OE ankuesve AK Invest Dooel & Hidro Project SHPK & Benita Company SHPK & Engroup SHPK janë shpallur të pasuksesshëm me çmimin më të lartë.

I njëjti pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues, parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se vlerësimi dhe ekzaminimi i ofertave nuk është bërë konform Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht janë shkelë dispozitat ligjore: 4,7,10,52,60,65,69,72, dhe Aktet nënligjore: rregullorja për prokurim publik nr.001/2022 neni 44 par 44.1 dhe 44.3. dhe udhëzuesi për prokurim publik.

“Vërejtje: Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të parashtruara në ankesë, gjenden tek pjesa lartë e raportit, saktësisht tek Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore”

Përgjigje në pretendimet ankimore të operatorit ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar:

Pretendimi i parë:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, Marrëveshja e konzorciumit përmban të gjitha elementet e marrëveshjes sipas pikave a,b,c të nenit 26 të LPP-së sipas kushteve dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP-së, andaj mos përfshirja e “header” ose “footer” në fund dhe fillim të faqes nuk mund të jenë relevante dhe arsye e eliminimit, për faktin se siç përcakton edhe OE ankues i cili citon nenin 44 të rregullores për prokurim publik në

të cilën theksohet se ofertuesit nuk lejohet të fshijnë përmbajtjen por mund të shtojnë logo, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes, atëherë ky detaj nuk mund të eliminoj grupin e rekomanduar, sepse meqë lejohet që në header të vendoset logo apo emër, dhe duke qenë se data, titulli dhe numri i prokurimit gjenden në brendësi të marrëveshjes, atëherë si e tillë ky detaj mund të trajtohet sipas nenit 59.4 të LPP-së.

Sa i përket potencimit të OE ankues në ankesë lidhur me eliminimin e ofertuesve të tjerë në këtë aktivitet për marrëveshjen e konzorciumit, ekspertja shqyrtuese sqaron se, rastin e parë të cilën e përdorë OE ankues si vlerësim me standarde të dyfishta nga AK, mund të sqarohet se, marrëveshja e konzorciumit të Grupit R&R Rukolli, të njëjtit nuk kanë vendosur fare përqindjen e pjesëmarrjes në tender, andaj edhe janë eliminuar, gjithashtu edhe rasti i dytë i përmendur nga OE ankues ka të bëjë me eliminimin e grupit për arsye se kanë fshirë pjesën e përmbajtjes tek kërkesa personi i autorizuar dhe si e tillë eliminohet. Dhe duke qenë se këto dy raste nuk përkojnë me pretendimin e ngritur për grupin e rekomanduar, atëherë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Ndërsa legjitimiteti i nënshkrimeve, AK konform nenit 52.7 të LPP-së, mund të bëjë një kontrollë efektive nëse dyshon, për arsye se ofertat dorëzohen në mënyrë elektronike nga të gjithë ofertuesit.

Pretendimi i dytë:

Ekspertja shqyrtuese pretendimi e tretë e konsideron të pa bazuar, për faktin se kërkesa e AK-së në DT është:

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë që mund ti përdori për këtë projekt ose mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti - limit financiar te aprovuar ne emer te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro.

Për OE pretendent per kontratë, para shpalljes si fitues, AK do i vërtetoj dëshmitë e ofruara te gjendjes financiare, a i disponon mjetet e gatshme në bankë ose mbështetjen bankare.

Dëshmia 2. Letër konfirmimi nga banka që dëshmon se OE ose GOE ka mjete të gatshme ne llogarinë e tijë bankare qe mund ti përdori për këtë projekt ose limit financiar te aprovuar ne emër te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga banka.

Dhe si e tillë, në ofertën e Grupit të rekomanduar gjenden dy letër konfirmime në dy banka, të cilat konfirmojnë limitin e aprovuar 4+4 milion, dhe rrjedhimisht sipas DT-së, AK për letër konfirmimin nga banka PCB ka kërkuar edhe një sqarim vërtetim për përkrahje, për arsye se ky dokument ka vërtetuar fillimisht se mund të përdoret citat: “ 4 Milion euro të cilat mund ti përdorë për nevojat e biznesit duke përfshirë dhe për projektin e cekur më lartë” dhe si e tillë, meqë banka nuk ka qartësuar se këto mjete duhet të përdoren vetëm për projektin në fjalë, (përkundër që edhe fjalia për nevojat e biznesit është në kuadër të projektit si punë e kontraktuar/tender), atëherë AK kërkon që të sigurohet se arrin vlerën 8 Milion OE fitues, dhe rrjedhimisht ka pranuar konfirmimin e kërkuar nga PCB e cila e plotëson kërkesën, ndërsa tender garancioni është depozitë tjetër për sigurim të tenderit. Pretendimi i pa bazuar.

Pretendimi i tretë:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër grupit të rekomanduar për kontratë sqaron se, pretendimi ankimor i ngritur pothuajse nga të gjitha operatorët ekonomik ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, lidhur me vërtetimin tatimor të anëtarit të tretë të konzorciumit, i cili para dorëzimit të tenderit ka ofruar marrëveshjen për shlyerje të borxheve me këste sipas kërkesës në dosje të tenderit, e cila marrëveshje sipas ekspertës shqyrtuese merret e mirëqenë për faktin se, referuar edhe interpretimit të Krpp-së nr.6 të datës 22.11.2022, borxhet mund të lindin edhe gjatë vlerësimit, fazën e ankimit etj, dhe si e tillë në momentin që lidhet marrëveshja për shlyerje, ky borxh ndërron statusin duke u ristrukturuar, çka do të thotë marrëveshja mund të merret e mirëqenë, sepse po që se do të kishte borxh/obligime pa marrëveshje, në sistem do të kishte gjendjen tatimore “ OE ka borxhe tatimore dhe ka obligime tatimore të pa paguara” dhe gjithashtu nuk do mund ta gjeneronte fare këtë vërtetim. Ky mendim i ekspertës shqyrtuese mbështetet në Udhëzuesin nr. 01/2024 lidhur me procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës bazuar në ligjin nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore Ligjin, neni 4 dhe neni 5 i udhëzuesit. Andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Pretendimi i katërt:

Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues kundër fituesit ekspertja sqaron se, në ofertën e GOE fitues gjendet lista e stafit profesional, me listë të ATK-së për kontributet e realizuara së paku për tre muaj gjatë 12 mujorit të fundit, ndërsa nga e cila listë e stafit e ofruar në ofertë nga GOE i rekomanduar, vetëm dy nga inxhinierët janë me kontratë mbi vepër, ose marrëveshje për projektin, me pagë dhe orar sipas kërkesave të kompanisë në realizim të punëve. Kurse sa i përket pagës së potencuar nga OE ankues për disa nga stafi, mund të sqarohet se, kontrata e punës është e lidhur për gjysmë orari e cila edhe në ATK është e deklaruar sekondare! Mirëpo të gjitha këto konteste të OE ankues janë në përgjegjshmëri të kompanisë angazhuese, e cila është e obliguar që të respektoj ligjin e punës, dhe si e tillë, kontratat e përmendura nga OE ankues, sa i përket orarit dhe pauzës, konsiderohen se janë në favor të punëtorit dhe nuk ka diskriminim, pra ligji i punës e parashikon minimum pauzën dhe nëse biznesi lejon më tepër është në diskresion dhe strategji të tyre, e rëndësishme në kontrata është të mos shkelen të drejtat e punëtorit duke i respektuar parimet.

Kurse sipas ligjit të punës, kontratat përmbushin elementet e kontratës së punës, të cilat përfshijnë: të dhënat e punëdhënësit (emri, adresa, numri i biznesit), të dhënat e punëmarrësit (emri, mbiemri, numri personal, adresa), data e fillimit të punës, përshkrimi i detyrave: pozita, natyra e punës, përgjegjësitë , kohëzgjatja e kontratës, orari i punës (i plotë, pjesshëm, me turne etj), të drejtat dhe detyrimet e palëve, nënshkrimet e palëve etj. Andaj edhe ashtu kontrata si definicion i përket marrëveshjes në mes dy palëve. Pretendimi nuk gjendet i qëndrueshëm.

Dëshmia 3.

- Lista e stafit profesional (min. 6 inxhinierë), me te dhënat dhe profilin e secilit, original e nënshkruar dhe vulosur;
- Për inxhinierët e rregullt kërkohet Lista e ATK-se me kontributet e realizuara se paku për tre muaj gjatë 12 mujorit te fundit nga Njoftimi për kontratë;
- Për inxhinierët jo të rregullt kërkohet marrëveshja e punës për këtë projekt konform Ligjit te Punës, të nënshkruara nga të dyja palët;

- Diploma e fakultetit sipas sistemit 5 vjeçar ose master;
- CV e nënshkruar nga inxhinieri;
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës;

Sidomos per OE pretendues për kontratë AK do ta verifikoj vërtetësinë e dëshmive per secilin inxhinier

Si përfundim:

Sqarim: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar katër ankesa më nr: 1172/2025; 1173/2025; 1175/2025 dhe 1182/2025.

Ekspertja shqyrtuese, lidhur me ankesat e parashtruara kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, sqaron se, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat në përputhje me nenet 1, 6, 7 dhe 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik, për faktin se grupi i rekomanduar ka ofruar çmimin më të ulët të përgjegjshëm, ndërkohë që diferenca me ofertat e operatorëve ankues varion nga 659 mijë e 752 euro deri në 2 milion e 877 mijë e 462 euro, dhe vlen të theksohet se asnjëri nga ankuesit nuk ka kontestuar çmimin e ofruar të këtij grupi të rekomanduar.

Pretendimet ankimore të operatorëve ankues ndaj grupit të rekomanduar janë kryesisht të ngjashme, me disa shtesa të veçanta, por kontestet kryesore mbeten të njëjta, të cilat janë sqaruar brenda secilës ankesë.

Prandaj, ekspertja shqyrtuese rekomandon panelin shqyrtues që ankesa e operatorit ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi, meqenëse pretendimet kundër grupit të operatorëve të rekomanduar nuk rezultojnë të qëndrueshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1173, i cili është dorëzuar me datë 19.12.2025

Lidhur me pretendimet e OE **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1173 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti” me nr. të prokurimit: "206-25-80-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12/11/2025.

OE ankues **YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi & Limit Project SHPK**, në Vendimin e AK-së është shpallë i eliminuar me arsyetimin:

ARSYETIM

Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

Lidhur me kriterin 1 te kërkesat- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturorë, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme. Në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - original e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna: - - - - Titullin kontratës, Investitorin, Të dhënat e personit kontaktues, Datën e përfundimit të projektit, Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të lëshuara nga Kompani të licencuara - të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do të verifikoj transaksionet bankare të projekteve private.

Grup i OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi, LIMITPROJECT SH.P.K ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 ₺. Projektet e papranueshme të OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi: Referenca nr.1 e lëshuar nga AIRPORT OPERATION AND AVIATION INDUSTRIES INC. (HEAS) për projektin Kursi i kembimit Lira/Euro: 1 TRY = 0.0266 EUR (Burim: ExchangeRates.org.uk4 TRY/EUR Historical Rates 2024).

September 2024 Date Sunday 1 September 2024 Turkish Lira to Euro £1 TRY = -0.0266 Link to Date TRY/EUR rate for 01/09/2024

Llogaritja: $282,750,250 \text{ TRY} \times 0.0266 = 7,521,156.65 \text{ ₺}$ - Diferenca prej më shumë se 38 milionë ₺ - tregon gartë mospërputhje dhe vë në dyshim saktësinë dhe besueshmërinë e dokumentit. Dokumenti i paraqitur nuk pasqyron kursin zyrtar të këmbimit në datën e lëshimit dhe kjo mund të verifikohet në mënyrë të besueshme nga burime të pavarura financiare, sistemi ExchangeRates.org.uk. Për shkak të këtij devijimi të madh në mes kursit real dhe atij të prezantuar, vlera e prezantuar në referencë nuk mund të pranohet si provë e vlefshme për përmbushjen e kërkesës së aktivitetit të prokurimit, meqenëse ka dallim shumë të madhe me vlerën reale të konvertimit në atë kohe. Kriterin 1 të kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qene se në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit, që në këtë rast nuk OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi nuk e mbërrin vlerën e kërkuar për punët e kryera po ashtu edhe anëtar i konsorciumit LIMITPROJECT SH.P.K si anëtar i grupit nuk ka arritur të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të kërkuar.

Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform Ligjit Për Prokurim Publik përkatësisht ka shkelë dispozitat ligjore: 1,7,27,59,68,69 si dhe nenet 2,26,27,41 të Rregullores për Prokurim Publik.

“Vërejtje: Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të parashtruara në ankesë, gjenden tek pjesa lartë e raportit, saktësisht tek Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore”

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër eliminimit nga AK:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e grupit të operatorëve ankues gjendet lista e projekteve, ndër të cilat AK meqë projektet janë ndërkombëtare, ka qenë e nevojshme që të bëjë konvertimin e vlerës në valutën Euro, dhe rrjedhimisht sipas ligjit për kontabilitet dhe raportim financiar në Kosovë Nr.04/ L-014 -Neni 6 Librat kontabël dhe evidencat mbështetëse, kërkohet që të dëshmohet sipas datës së pagesës, në rastin konkret duhet të hulumtohet data kur është bërë pagesa e punëve të kryera, e në këtë rast nga AK është konsideruar se është data e referencës, mirëpo meqë këto projekte apo vlera nevojiten për kalkulim të vlerës si kërkesë e caktuar në DT, atëherë meqë sipas LPP-së nuk definohet një gjë e tillë, rrjedhimisht mbetet të përcaktohet sipas ligjeve të tjera në fuqi. Megjithatë, për këto referenca në vlerësim ka qenë e nevojshme që të kërkohen dëshmi shtesë, përkthim etj, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar, për faktin se projektet që kanë të bëjnë më shtetet tjera të cilat kanë valutë tjetër po që se objekt kontesti për përgjegjshmëri dhe rekomandim të kontratës janë vetëm projektet e përfunduara, atëherë nevojitet përkthimi dhe të kërkohen dëshmi shtesë si psh. llogaritë bankare, ose çfarëdo dokumenti që e dokumenton vërtetësinë e referencës dhe vlerës.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar:

Pretendimi i parë:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, Marrëveshja e konzorciumit përmban të gjitha elementet e marrëveshjes sipas pikave a,b,c të nenit 26 të LPP-së sipas kushteve dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP-së, andaj mos përfshirja e “header” ose “footer” në fund dhe fillim të faqes nuk mund të jenë relevante dhe arsye e eliminimit, për faktin se siç përcakton edhe OE ankues i cili citon nenin 44 të rregullores për prokurim publik në të cilën theksohet se ofertuesit nuk lejohet të fshijnë përmbajtjen por mund të shtojnë logo, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes, atëherë ky detaj nuk mund të eliminoj grupin e rekomanduar, sepse meqë lejohet që në header të vendoset logo apo emër, dhe duke qenë se data, titulli, numri i prokurimit, dhe pwrqindja e pjesëmarrjes në grup gjenden në brendësi të marrëveshjes, atëherë si e tillë ky detaj mund të trajtohet sipas nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi i dytë:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër grupit të rekomanduar për kontratë sqaron se, pretendimi ankimor i ngritur pothuajse nga të gjitha operatorët ekonomik ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, lidhur me vërtetimin tatimor të anëtarit të tretë të konzorciumit, i cili para dorëzimit të tenderit ka ofruar marrëveshjen për shlyerje të borxheve me këste sipas kërkesës në dosje të tenderit, e cila marrëveshje sipas ekspertës shqyrtuese merret e mirëqenë për faktin se, referuar edhe interpretimit të Krpp-së nr.6 të datës 22.11.2022, borxhet mund të lindin edhe gjatë vlerësimit, fazën e ankimit etj, dhe si e tillë në momentin që lidhet marrëveshja për shlyerje, ky borxh ndërron statusin duke u ristrukturuar, çka do të thotë marrëveshja mund të merret e mirëqenë, sepse po që se do të kishte borxh/obligime pa marrëveshje, në sistem do të kishte gjendjen tatimore “ OE ka borxhe tatimore

dhe ka obligime tatimore të pa paguara” dhe gjithashtu nuk do mund ta gjeneronte fare këtë vërtetim. Ky mendim i ekspertës shqyrtuese mbështetet në Udhëzuesin nr. 01/2024 lidhur me procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës bazuar në ligjin nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore Ligjin, neni 4 dhe neni 5 i udhëzuesit. Andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Pretendimi i tretë:

OE ankues lidhur me pretendimin e tretë nuk ka sqaruar se cili nga projekti nuk posedon reference, mirëpo në pjesën e përgjigjes së AK-së në kërkesën për rishqyrtim, vërejmë se OE ankues pretendon se Grupi fitues nuk përmbushë kërkesën 8.1&8.2 lidhur me referencën e bankës, mirëpo në ofertën e Grupit të rekomanduar gjenden dy letër konfirmime në dy banka, të cilat konfirmojnë limitin e aprovuar 4+4 milion, dhe rrjedhimisht sipas DT-së, AK për letër konfirmimin nga banka PCB ka kërkuar edhe një sqarim vërtetim për përkrahje, për arsye se ky dokument ka vërtetuar fillimisht se mund të përdoret citat: “ 4 Milion euro të cilat mund ti përdorë për nevojat e biznesit duke përfshirë dhe për projektin e cekur më lartë” dhe si e tillë, megjë banka nuk ka qartësuar se këto mjete duhet të përdoren vetëm për projektin në fjalë, (përkundër që edhe fjalia për nevojat e biznesit është në kuadër të projektit si punë e kontraktuar/tender), atëherë AK kërkon që të sigurohet se arrin vlerën 8 Milion OE fitues, dhe rrjedhimisht ka pranuar konfirmimin e kërkuar nga PCB e cila e plotëson kërkesën. Pretendimi i pa bazuar.

Pretendimi i katërt:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e katërt sqaron se, AK në DT ka kërkuar dëshmi listat e ATK-së vetëm për inxhinierët që janë të rregullt:

- Për inxhinierët jo të rregullt kërkohet marrëveshja e punës për këtë projekt konform Ligjit të Punës, të nënshkruara nga të dyja palët;

Mirëpo pas analizimit të listave të ATK-së nga Grupi i rekomanduar, shihet se disa nga stafi profesional gjendet në Listat e ATK-së nga Lideri, dhe një pjesë janë nga anëtarët e konzorciumit, mirëpo gjithashtu gjenden edhe staf të cilët janë më kontratë mbi vepër lidhur me angazhimin në këtë projekt, andaj pretendimi nuk gjendet i bazuar.

Si përfundim:

Sqarim: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar katër ankesa më nr: 1172/2025; 1173/2025; 1175/2025 dhe 1182/2025.

Ekspertja shqyrtuese, lidhur me ankesat e parashtruara kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, sqaron se, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat në përputhje me nenet 1, 6, 7 dhe 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik, për faktin se grupi i rekomanduar ka ofruar çmimin më të ulët të përgjegjshëm, ndërkohë që diferenca me ofertat e operatorëve ankues varion nga 659 mijë e 752 euro deri në 2 milion e 877 mijë e 462 euro, dhe vlen të theksohet se asnjëri nga ankuesit nuk ka kontestuar çmimin e ofruar të këtij grupi të rekomanduar.

Pretendimet ankimore të operatorëve ankues ndaj grupit të rekomanduar janë kryesisht të ngjashme, me disa shtesa të veçanta, por kontestet kryesore mbeten të njëjta, të cilat janë sqaruar brenda secilës ankesë.

Prandaj, ekspertja shqyrtuese rekomandon panelin shqyrtues që ankesa e operatorit ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi, meqenëse pretendimet kundër grupit të operatorëve të rekomanduar nuk rezultojnë të qëndrueshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1175, i cili është dorëzuar me datë 19.12.2025

Lidhur me pretendimet e OE Raf II Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1175 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti” me nr. të prokurimit: "206-25-80-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12/11/2025.

Grupi i OE ankuesve Raf II SHPK & Fitorja SHPK sipas letrës standarde nga Autoriteti Kontraktues janë eliminuar me arsyetimin:

ARSYETIM

Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim: Lidhur me kriterin 1 të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

9.1 & 9.2 | Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo më pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme. Në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin | Të Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna: - Titullin kontratës, - Investitorin, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata të pranimit të leshuara nga Kompani të licencuara - Të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do të verifikoj transaksionet bankare të projekteve private.

Juë keni dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej

35,000,000.00.

Data e Njoftimit për Kontratë për këtë aktivitet është 02.04.2025, prandaj pranohet vetëm përvoja e realizuar gjatë periudhës nga 02.04.2022 deri më 02.04.2025.

Projektet e papranueshme të OE Raf II sh.p.k:

1.Projekti nr. 1- Construction of a new Sports Center “Onmnisport” (3,811,419.57 E).

Referenca e lëshuar më 18.03.2022 4 nuk hyn në periudhën e kërkuar (pas 02.04.2022).

2.Projekti nr. 5 -Construction of Rendering Plant Category 1 for Animal By-Products Lot I & Lot 2 (2,940,401.45 ₺). Përfunduar në 03.2022 4 jashtë periudhës së kërkuar.

3.Projekti nr. 6 - Upgrade of Infrastructure Lot I (1,056,351.40 ₺). Nuk pranohet, pasi që referencat nuk janë të nënshkruara nga autoriteti kompetent.

4.Projekti nr. 7 -Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special Shtime (në vazhdim). Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar.

Vlera totale e projekteve të realizuara nga OE Raf II sh.p.k. e që janë konform periudhën kohore të përcaktuar në dosje të tenderit, vlera totale e projekteve të pranueshme është 17,624,479.02 ₺.

Projektet e papranueshme të OE Fitorja SH.P.K:

Projekti nr. 4 - Ndërtimi i Kompleksit banesor Ferizaji Ri Llam. B në Ferizaj, në vlerë 16,888,793,08 ₺, statusin e ka në vazhdim - Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar, ndërsa kërkesa e tenderit është “...të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjetecare nga Njoftimi për Kontratë”.

Projekti nr. 5 7-ndërtimi i Kompleksit banesor Ferizaji Ri Llam. C në Ferizaj, në vlerë 5,715,723.40 ₺, statusin e ka në vazhdim - Nuk pranohet pasi nuk është i përfunduar, ndërsa kërkesa e tenderit është <...të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjetecare nga Njoftimi për Kontratë”.

Vlera totale e projekteve të realizuara nga OE Fitorja SH.P.K e që janë konform periudhës kohore të përcaktuar në dosje të tenderit, vlera totale e projekteve të pranueshme është 11,987,620.42 ₺.

Totali i projekteve të pranuar:

Fitorja SH.P.K. = 11,987,620.42 ₺

Raf II sh.p.k. =17,624,479.02 ₺

Totali i GOE = 29,612,099.44 Euro

Duke qenë se vlera totale e projekteve të realizuara është 29,612,099.44 Euro, e cila është më e ulët se kërkesa minimale prej 35,000,000.00 Euro, Grupi i Operatoreve Ekonomik Raf II sh.p.k. & Fitorja SH.P.K. nuk e përmbush kriterin kryesor nr. 1 të Kapaciteti teknike dhe profesional sipas nenit 9.1 & 9.2 të NJK dhe Dosjes së Tenderit.

Tutje, OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP pretendon se, Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar ofertat drejtë dhe se gjatë vlerësimit shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,7,52,56,59,60,69,72,dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik, për arsye se të njëjtit pretendojnë se plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, duke atakuar gjithashtu edhe Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

“Vërejtje: Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të parashtruara në ankesë, gjenden tek pjesa lartë e raportit, saktësisht tek Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore”

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër arsye së eliminimit të OE ankues kundër Ak-së:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankues gjendet lista e projekteve nga të cilat AK projektet me numrat rendor 1,5,6,7 të liderit, nuk pranohen me arsyetimin se data e përfundimit është më tepër se 3 vjet dhe projektet me numrat 4 dhe 5 janë ende pa përfunduar. Rrjedhimisht bazuar në shkresat dhe pretendimet e OE ankues, projekti me numër 6 nga dëshmitë mund të pranohet, ndërsa projektet 1 dhe 5 i njëjti dëshmon se bashkëngjitë dëshmi shtesë lidhur me datën e përfundimit si referencë mbi përfundimin final të punëve, mirëpo më ankesë nuk janë të bashkëngjitura. Gjithashtu këto projekte duhet të analizohen se nëse janë projekte të ngjashme ndërtim dhe renovim sipas dosjes së tenderit, andaj po që se objekt kontesti për përgjegjshmëri dhe rekomandim të kontratës janë vetëm projektet e përfunduara, atëherë nevojitet të kërkohen dëshmi shtesë, mirëpo aktualishtë nuk përmbushë vlerën e kërkuar 35 milion. Pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër Grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, OE ankues pretendon se Grupi i OE të rekomanduar nuk plotëson kërkesat 9.1&9.2 Projektet e përfunduara 35 Milion Euro. Pas analizimit të listës së ngarkuar në ofertë nga GOE i rekomanduar ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi nuk gjendet i qëndrueshëm për faktin se, AK në Dosjen e Tenderi te ndryshuar me datë 21/07/2025, si dëshmi AK ka specifikuar se mund të pranohen refrenca, paramasa per projektet private, vendimi nga Komuna etj, andaj edhe nëse kalkulimi bëhet duke zbritur projektet të cilat janë furnizim me pajisje termoenergjetike, dhe punët makinerike, përkatësisht projektet e renditura me numër: 7.11,12,13,14,15 dhe 16, prap arrinë vlerën 35 milion, dhe si e tillë merren të mirëqenë. Pretendim i pa qëndrueshëm.

Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, te përfunduara gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë.

Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe te ngjashme. Në rast të grupit te oe, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet t'i ketë këto te dhëna:

- Titullin kontratës,

- Investitorin,
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e përfundimit të projektit,
- Vlerën e projektit.

Për çdo projekt te realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale).

Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve te kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata te pranimit te leshuara nga Kompani te licencuara - Te autorizuar per kete qellim ne vendin ku ndertimi eshte realizuar.

Per OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare te projekteve private.

Pretendimi i dytë:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, AK në DT ka kërkuar:

Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit (2022-2023-2024) ka qenë në vlerë se bashku në të tri vitet jo me pak se dyzetepesë (45) milion Euro. Ne rast te grupit te OE, se paku 51% te qarkullimit te plotësohet nga lideri i grupit.

Dëshmia 1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për qarkullimin vjetor te OE, gjatë tre viteve te fundit (2022-2023-2024) ne vlerë se bashku jo me pak se dyzetepesë (45) milion Euro. (për kompani ndërkombëtare kërkohen deklaratat tatimore nga autoriteti ekuivalent).

Megjithatë, ne ofertën e GOE fitues gjenden deklaratat e ATK-së me qarkullim mbi vlerën e kërkuar nga AK, e cila mbi 51% e qarkullimi mbulohet nga Lideri si dhe pjesa tjetër është nga anëtarët e konzorciumit që plotësohet si grup në tërësi konform nenit 26 të LPP-së, andaj pretendimi i OE ankues lidhur me humbjen e deklaruar nga fituesit është deklarimet tek pjesa e aktivitetit jo operativ, andaj ky pretendim sipas nenit 56.3 dhe nenit 68 të Ligjit Për Prokurim Publik nuk mund të merret në vlerësim. Pretendimi i OE ankues i pa bazuar.

Pretendimi i tretë:

Ekspertja shqyrtuese pretendimi e tretë e konsideron të pa bazuar, për faktin se kërkesa e AK-së në DT është:

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë qe mund ti përdori për këtë projekt ose mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti - limit financiar te aprovuar ne emer te projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro.

Për OE pretendent per kontratë, para shpalljes si fitues, AK do i vërtetoj dëshmitë e ofruara te gjendjes financiare, a i disponon mjetet e gatshme në bankë ose mbështetjen bankare.

Dëshmia 2. Letër konfirmimi nga banka që dëshmon se OE ose GOE ka mjete të gatshme në llogarinë e tijë bankare që mund ti përdori për këtë projekt ose limit financiar të aprovuar në emër të projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga banka.

Dhe si e tillë, në ofertën e Grupit të rekomanduar gjenden dy letër konfirmime në dy banka, të cilat konfirmojnë limitin e aprovuar 4+4 milion, dhe rrjedhimisht sipas DT-së, AK për letër konfirmimin nga banka PCB ka kërkuar edhe një sqarim vërtetim për përkrahje, për arsye se ky dokument ka vërtetuar fillimisht se mund të përdoret citat: “ 4 Milion euro të cilat mund ti përdorë për nevojat e biznesit duke përfshirë dhe për projektin e cekur më lartë” dhe si e tillë, meqë banka nuk ka qartësuar se këto mjete duhet të përdoren vetëm për projektin në fjalë, (përkundër që edhe fjalia për nevojat e biznesit është në kuadër të projektit si punë e kontraktuar/tender), atëherë AK kërkon që të sigurohet se arrihet vlerën 8 Milion OE fitues, dhe rrjedhimisht ka pranuar konfirmimin e kërkuar nga PCB e cila e plotëson kërkesën. Ndërsa data e konfirmimit është para dorëzimit të ofertës, e cila datë merret e mirëqenë. Pretendimi i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër ofertuesit Grupi ”Nika Pro-ing & Aktiv SHPK & Anion Mep Contracting

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik Nika Pro-ing & Aktiv SHPK & Anion Mep Contracting sqaron se, ky grup pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK të njëjtit kanë parashtruar ankesë pranë OSHP-së me nr. 1282/2025, andaj këto pretendime ankimore janë shqyrtuar në ankesën e potencuar. Pretendimi gjendet i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër ofertuesit Grupi ”R & Rrukolli & Limora SHPK & Valmir Loshi B.I :

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër grupit ” R & Rrukolli & Limora SHPK & Valmir Loshi B.I, shpjegon se, të njëjtit janë eliminuar nga AK me arsyetimin se marrëveshja e konzorciumit nuk është plotësuar në rregull, dhe si e tillë janë eliminuar me të drejtë nga AK, për faktin se, ky grup nuk kanë përcaktuar fare përqindjen e realizimit të projektit si grup. Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër ofertuesit Grupi “Teskon Proses Degerrli adenler Fonansal Danismanlik TIC LTD. ST & Fidola SHPK

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, ky grup i ofertuesve është eliminuar për arsye se gjatë plotësimit të marrëveshjes, të njëjtit kanë fshirë një pjesë të marrëveshjes ku përcaktohet personi i autorizuar, andaj si e tillë meqë të njëjtit nuk kanë kontestuar përgjegjshmërinë e tyre me ankesë pranë OSHP-së, atëherë të njëjtit janë pajtuar me vlerësimin nga Autoriteti Kontraktues. Pretendimi i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër ofertuesit Grupi “Ybt Insaat ve Ticaret Limites Sirketi & Limit Project SHPK:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundër grupit të OE “Ybt Insaat ve Ticaret Limites Sirketi & Limit Project SHPK sqaron se, ky grup i OE gjithashtu janë në këtë procedurë të ankimit në OSHP dhe si e tillë pretendimet ankimore mbi arsyet e eliminimit të tyre gjenden pjesërisht të bazuara sipas sqarimit në lëndën 2025/1173.

Tutje, OE ankues në ankesë në kundërshtim më Rregulloren për Prokurim Publik përkatësisht nenit 64.2, kanë shtuar pretendime ankimore edhe kundër Grupit AK Invest Dooel & Hidro Project SHPK & Benita Company SHPK & Engroup SHPK të cilat pretendime nuk kanë qenë në kërkesën për rishqyrtim.

Citat Rrpp. 001/2022 dt.11.11.2024:

64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar “Ankesat”. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues

Si përfundim:

Sqarim: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar katër ankesa më nr: 1172/2025; 1173/2025; 1175/2025 dhe 1182/2025.

Ekspertja shqyrtuese, lidhur me ankesat e parashtruara kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, sqaron se, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat në përputhje me nenet 1, 6, 7 dhe 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik, për faktin se grupi i rekomanduar ka ofruar çmimin më të ulët të përgjegjshëm, ndërkohë që diferenca me ofertat e operatorëve ankues varion nga 659 mijë e 752 euro deri në 2 milion e 877 mijë e 462 euro, dhe vlen të theksohet se asnjëri nga ankuesit nuk ka kontestuar çmimin e ofruar të këtij grupi të rekomanduar.

Pretendimet ankimore të operatorëve ankues ndaj grupit të rekomanduar janë kryesisht të ngjashme, me disa shtesa të veçanta, por kontestet kryesore mbeten të njëjta, të cilat janë sqaruar brenda secilës ankesë.

Prandaj, ekspertja shqyrtuese rekomandon panelin shqyrtues që ankesa e operatorit ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi, meqenëse pretendimet kundër grupit të operatorëve të rekomanduar nuk rezultojnë të qëndrueshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1182, i cili është dorëzuar me datë 19.12.2025

Lidhur me pretendimet e OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1182 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti” me nr. të prokurimit: "206-25-80-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12/11/2025.

Grupi i OE ankuesve Nika Pro-ing SHPK & Aktive Shpk & Anion Mep Contracting SHPK sipas letrës standarde nga Autoriteti Kontraktues janë eliminuar me arsyetimin:

ARSYETIM

Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet në vijim: Lidhur me kriterin 2 te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare:

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, duhet të ketë të paktën tetë (8) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën tetë (8) milion Euro qasje për kredi në dispozicion.

Për OE pretendent për kontratë, para shpalljes si fitues, AK do i vërtetoj dëshmitë e ofruara nga banka.

Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) nga banka për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej tetë (8) milion EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Ju keni ofruar një letër mbështetje të lëshuar nga Raiffeisen Bank me datë 25 korrik 2025, në emër të Active SHPK. Në këtë shkresë banka shpreh gatishmërinë për të mbështetur OE me kredi në vlerë prej 8 milion euro për implementimin e projektit/tenderit “Ndërtimi i objektit të spitalit të përgjithshëm në Ferizaj- vazhdim i projektit”, me nr. Të prokurimit 206-25-80-5-1-1, por me kusht që klienti të plotësoj kriteret dhe kushtet e brendshme të bankës për një kredi të tillë.

Duke u bazuar në kërkesën e përcaktuar në dosje të tenderit, ku është specifikuar qartë se OE/GOE duhet të ketë asete likuide në llogari ose qasje për kredi në dispozicion, letra e paraqitur nga banka nuk përmbush kriterin e kërkuar. Arsyeja është se dokumenti i ofruar është i kushtëzuar nuk garanton disponueshmërinë e shumës, por vetëm mundësinë për të marrë kredi nëse i plotësohen kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. SI e tillë, kjo letër nuk e plotëson kriterin e lartcekur.

Lidhur me kriterin 1 te kërkesat mbi ,mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte të ngjajshme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se tridhjetepesë (35) Milion Euro, te përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë.

Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe te ngjashme. Në rast të grupit të oe, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet t'i ketë këto të dhëna:

- Titullin kontratës,
- Investitorin,
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e përfundimit të projektit,

- Vlerën e projektit.

Për çdo projekt te realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (te përkohshme ose finale).

Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve te kryera, certifikata e pranimit nga komuna ose Certifikata e pranimit te leshuara nga Kompani te licencuara - Te autorizuar per kete qellim ne vendin ku ndertimi eshte realizuar.

Per OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare te projekteve private.

Grupi i Operatorëve Ekonomik Nika Pro-Ing SHPK: Aktive SHPK; Anion Mep Contracting ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara, të vulosur dhe të nënshkruar. Megjithatë, vlera totale e projekteve të përfunduara brenda periudhës së kërkuar nuk e arrin pragun prej 35,000,000.00 Euro.

Lideri i grupit OE Anion Mep Contracting e ka ofruar një listë për punët e realizuara, së bashku me kontratat dhe referencat, sipas listës së dorëzuar projektet me nr. Rendor 5 dhe 6 nuk janë të pranueshme pasi që nuk janë të përfunduara- JANË NË REALIZIM,

Ndërsa projektet në listë me nr. 1,2,3 dhe 4 janë projekte ku OE Anion Mep Contracting ka qenë i angazhuar si nënkontraktor, ku ka ofruar kontratat e lidhura me OE Generic Engineering Technologies & Contracting Ë.L.L dhe Sigma Contracting & Trading Ë.L.L dhe referencat e lëshuara nga këta dy OE Ekonomik.

Bazuar në kriterin e lartëcekur për projektet e realizuara për investitorë privat, është e domosdoshme paraqitja e certifikatës së pranimit nga komuna ose certifikatave të pranimit të lëshuara nga kompani të licencuara e të autorizuar në vendin ku është kryer ndërtimi. Këto dokumente nuk janë ofruar nga lideri i GOE, marr parasysh që është i përgjegjshëm edhe për çështjen e përkrahjes nga banka, nuk kemi kërkuar sqarime shtesë në këtë pikë.

Tutje, OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP pretendon se, Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar ofertat drejtë dhe se gjatë vlerësimit shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,6,7,59,69, për arsye se të njëjtit pretendojnë se plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, duke atakuar gjithashtu edhe Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

“Vërejtje: Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të parashtruara në ankesë, gjenden tek pjesa lartë e raportit, saktësisht tek Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore”

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër arsyes së eliminimit të tyre nga AK:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankues gjendet Letër mbështetja e lëshuar nga Raiffaisen Bank e cila specifikon se kredia do ti lëshohet nëse i plotëson kriteret e brendshme të bankës për një kreditim të tillë, gjithashtu specifikon se:”Ne Raiffaisen Bank JSC nuk kemi dhe nuk pranojmë asnjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit dhe/ose autoritetit kontraktues në bazë të këtij dokumenti të lëshuar”. Andaj si e tillë ekspertja shqyrtuese letër mbështetjen nga banka e konsideron të pa mirëqenë, për faktin se banka në paragrafin e fundit heq përgjegjësinë për sigurinë në mbështetje. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Tutje, arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues nga AK, lidhur me listën e projekteve të përfunduara, ekspertja shqyrtuese konsideron se nuk arrin vlerën 35 milion projekte të përfunduara, marrë parasysh se projektet e dy anëtarëve edhe nëse merren të gjitha, përbëjnë vlerën rreth 12 milion, ndërsa projektet e liderit të grupit, bazuar në dëshmitë e ofruara të cilat projekte janë nga kompanitë private, të njëjtat nuk kanë dëshmi si certifikatat e pranimit, paramasa ose dëshmi bindëse në ankesë lidhur me përfundimin e projekteve, dhe si e tillë, AK meqë letër mbështetja nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit duke rezultuar OE si i papërgjegjshëm, atëherë pretendimi i dytë nuk është e nevojshme të vlerësohet tutje me sqarim sipas nenit 72 të LPP. Andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar për faktin se lista e projekteve nëse është e pa kompletuar me dëshmitë e kërkuara, të njëjtat mund të kërkoet sqarim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar:

Pretendimi i pare:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundër grupit të rekomanduar për kontratë sqaron se, pretendimi ankimor i ngritur pothuajse nga të gjitha operatorët ekonomik ankues kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, lidhur me vërtetimin tatimor të anëtarit të tretë të konzorciumit, i cili para dorëzimit të tenderit ka ofruar marrëveshjen për shlyerje të borxheve me këste sipas kërkesës në dosje të tenderit, e cila marrëveshje sipas ekspertës shqyrtuese merret e mirëqenë për faktin se, referuar edhe interpretimit të Krpp-së nr.6 të datës 22.11.2022, borxhet mund të lindin edhe gjatë vlerësimit, fazën e ankimimit etj, dhe si e tillë në momentin që lidhet marrëveshja për shlyerje, ky borxh ndërron statusin duke u ristrukturuar, çka do të thotë marrëveshja mund të merret e mirëqenë, sepse po që se do të kishte borxh/obligime pa marrëveshje, në sistem do të kishte gjendjen tatimore “ OE ka borxhe tatimore dhe ka obligime tatimore të pa paguara” dhe gjithashtu nuk do mund ta gjeneronte fare këtë vërtetim. Ky mendim i ekspertës shqyrtuese mbështetet në Udhëzuesin nr. 01/2024 lidhur me procedurat e pajisjes me vërtetim tatimor e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës bazuar në ligjin nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore Ligjin, neni 4 dhe neni 5 i udhëzuesit. Andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Pretendimi i dytë:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues kundër grupit të rekomanduar sqaron se, AK në Aneks 1 ka dhënë një sqarim për OE si më poshtë citat:”

Sqarim për OE:

Ky aktivitet është bere i mundur te tenderohet bazuar ne Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 13/238 te datës 18.12.2024, me te cilin vendim Qeveria aprovon kërkesën e MSH-se për iniciimin e procedurave për projektin shumë-vjeçar dhe financimin në vlerën e planifikuar.

Arsye pse nuk është tenderuar si Ekonomikisht me i Favorshëm, por me kriterin e dhënies Çmimi me i Lirë, është sepse:

- Nuk e kemi konsideruar te drejte te poentohet afati i kryerjes se punëve me peshë te përqindje (%) përderisa buxheti është shumëvjeçar, por si afat i kryerjes se punëve kërkoet për 30 muaj, si dhe

- Nuk e kemi konsideruar te drejte te poentohet garancioni i kryerjes se punëve me peshë ne përqindje (%) përderisa punët e vrazhda janë kryer nga punëkryesi paraprak dhe e kemi konsideruar qe është me e drejte te kërkohet garancioni i punëve prej 24 muaj nga data e pranimit te përkohshëm te punëve te përfunduara deri ne pranimin final.”

Si e tillë, ky garancion kërkohet nga data e pranimit të përkohshëm i punëve të përfunduara deri në pranim final, dhe jo në vlerësim të ofertave, andaj pretendim nuk gjendet i qëndrueshëm.

Si përfundim:

Sqarim: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë parashtruar katër ankesa më nr: 1172/2025; 1173/2025; 1175/2025 dhe 1182/2025.

Ekspertja shqyrtuese, lidhur me ankesat e parashtruara kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, sqaron se, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat në përputhje me nenet 1, 6, 7 dhe 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik, për faktin se grupi i rekomanduar ka ofruar çmimin më të ulët të përgjegjshëm, ndërkohë që diferenca me ofertat e operatorëve ankues varion nga 659 mijë e 752 euro deri në 2 milion e 877 mijë e 462 euro, dhe vlen të theksohet se asnjëri nga ankuesit nuk ka kontestuar çmimin e ofruar të këtij grupi të rekomanduar.

Pretendimet ankimore të operatorëve ankues ndaj grupit të rekomanduar janë kryesisht të ngjashme, me disa shtesa të veçanta, por kontestet kryesore mbeten të njëjta, të cilat janë sqaruar brenda secilës ankesë.

Prandaj, ekspertja shqyrtuese rekomandon panelin shqyrtues që ankesa e operatorit ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi, meqenëse pretendimet kundër grupit të operatorëve të rekomanduar nuk rezultojnë të qëndrueshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik INVEST DOOEL Tetovo., **OE YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi.**, **OE Raf II Sh.P.K.**, si dhe **OE NIKA PrO – Ing Sh.P.K.**, duhet të Aprovohen si pjesërisht të bazuara, por të pa mjaftueshme për të ndryshuar epilogun përfundimtar të vendimmarjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë., lidhur me aktivitetin e prokurimit me Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj” me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1.

Në këtë rast, Paneli detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimor se, si dhe konstatimin e ekspertit shqyrtues se grupi i OE të rekomanduar ka ofruar çmimin më të ulët të përgjegjshëm, ndërkohë që diferenca me ofertat e operatorëve ankues varion nga 659 mijë e 752 euro deri në 2 milion e 877 mijë e 462 euro, e që ky fakt nuk ka mundur të mohohet as nga AK. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - AK INVEST DOOEL Tetovo, YBT Insaat ve Ticaret Limited Sirketi,, NIKA PrO-Ing SH.P.K., „Raf II"sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: